

Procesverbal

*Nga mbledhja e VI- (gjashtë) e rregullt e Kuvendit Komunal në Dragash , e mbajtur më datë:
29.06.2023*

Rend Dite

- 1) Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
- 2) Miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) 2024-2026,
- 3) Eventuale.

Uran Halimi: Përshëndetje të nderuar delegatë, si dhe ju të gjithë të pranishëm! Desha t'ju uroj festën e Kurban Bajramit! Njëherit edhe po fillojmë me seancën e VI-të të rregullt për vitin 2023 të Komunës së Dragashit, ku është propozu ky rend i ditës: në pikë të parë e kemi miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar, pika e dytë është miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore për vitin 2024-2026, pika e tretë dhe e fundit është pika eventuale. Nëse do me e marrë fjalën dikush në lidhje me rendin e ditës, përpara se ta hedhim në votim? Fjalën e ka kërkue z.Shpetim Hajredini.

Shpetim Hajredini: Faleminderit, i nderuar kryesues! Unë po e shfrytëzoj rastin, pra, pasi jemi në festën e Kurban Bajramit, në emër të grupit të PDK-së të ju uroj të gjithëve festën e Kurban Bajramit! Paqja dhe mëshira e Zotit qoftë dhe mbretëroftë mbi ju! Ju faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit, Shpetim! Dikush tjetër a do me e marrë fjalën në lidhje me rendin e ditës? Nëse jo, atëherë e hedhim në votim. Kush është pro rendit të ditës? Kush është kundër? Abstenim? Kemi 25 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, kalon rendi i ditës. Po vazhdojmë me pikën e parë, miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. Nëse dikush ka ndonjë vërejtje ose sugjerim në lidhje me procesverbalin, munden me e marrë fjalën. Nëse jo, atëherë e hedhim në votim. Kush është pro miratimit të pikës së parë të rendit të ditës, është fjala për procesverbalin e mbledhjes së kaluar? Kundër? Abstenim? I kemi 25 vota pro, zero kundër edhe zero abstenim. Po vazhdojmë me pikën e dytë me radhë, është miratimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore. Sigurisht që materialin e keni pas të servum edhe fizikisht edhe në mënyrë elektronike. Andaj, kush do me e marrë fjalën në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës, munden me e marrë fjalën. Fjalën e ka kërkue z.Shpetim Hajredini nga PDK.

Shpetim Hajredini: Faleminderit, i nderuar kryesues! Përshëndetje të nderuar drejtorë! Të nderuar kolegë asambleist! Përshëndetje qytetarë të nderuar të Dragashit! Sot po diskutojmë për KAB-in, një dokument shumë i rëndësishëm komunal. Unë personalisht nuk do të ndalem shumë tek materiali, të diskutoj gjerësisht, mirëpo do të mundohem me pika të shkurta t'i paraqes para jush ato lëshime të cilat, në bazë të meje, janë bërë nga ana e ekzekutivit. Do të kyçem direkt tek prioritetet e Komunës apo forcimi i ekonomisë komunale me mundësi të barabarta për të gjithë, rritja e ekonomisë komunale. Ni prej faktorëve kyç, të cilët ndikojnë në rritjen ekonomike komunale është, sipas ekzekutivit - po natyrisht që është dhe mbështetja edhe nga unë dhe nga të gjithë ata të cilët banojnë në këtë trevë - mbështetja direkte e sektorit bujqësor dhe blegtorisë përmes subvencionimit, është kështu do të thotë, grave dhe burrave fermerë. Kjo është shumë në rregull dhe e mbështes, që është ni prej pikave kyçe të zhvillimit komunal. Mirëpo, tek objektivat e Komunës së Dragashit nuk e kam vërejt që është parapa që do të ketë diçka ndryshim në bujqësi dhe blegtori. Prandaj, është dashtë që të jetë edhe në objektivat e Komunës së Dragashit, të kyçet si pikë e rëndësishme e zhvillimit të komunës. Mirëpo këtu nuk është fare dhe për mu kjo është lëshim dhe besoj që, deri në shtator është mirë që ta diskutoni si ekzekutiv dhe të jetë edhe në objektivat e komunës bujqësia dhe blegtoria. Do të vazhdoj dhe do kaloj direkt tek parashikimi apo shpenzimet komunale, dhe direkt tek shërbimet publike. Ju, i nderuar drejtor i Financave, keni qenë pjesëmarrës në shumicën e debateve apo takimeve që i kemi pasur në Kuvendin Komunal, dhe keni njohuri që kam bërë një kërkesë, dy herë kam kërkue nga kryetari që shpenzimet të cilat shkaktohen nga ndriçimi publik i fshatrave të përfshihen tani në këtë buxhet. Tek shërbimet publike po e shoh që gjithsejt janë 270 mijë për vitin 2023, në 2024-shin nëse nuk gaboje është rritur 343 mijë. E kam një pyetje direkte, i nderuar drejtor i Financave, besoj që keni njohuri në këtë drejtim. Kjo rritje është bërë për këtë qëllim, që të merren përsipër shpenzimet e

ndriçmit publik të fshatrave të cilët nuk janë për momentin të hyrë në komunë dhe nuk paguhen nga ana e komunës, por paguhen nga mjetet vetanake, apo është bërë kjo rritje për ndonjë shpenzim tjetër? Që kie mundësi tani me ma dhënë përgjigjen, ma jep direkt nga vendi! Debatimi që duhet me vazhduar unë është krejt diçka tjetër, nëse ma jep përgjigjen po ose jo. Okej, e lëmë atëherë e marrish fjalën, dal prapë. Do të thotë kjo është dashtë, në bazë të kërkesës time dhe premtimit të kryetarit, është dashtë të kyçet dhe të jetë në planifikim të këtij buxheti, por nëse nuk e keni planifikuar tani, besoj që deri në shtator, mundësitë e ndryshimit janë dhe është, mos të them e detyrueshme, por është shumë e arsyeshme që edhe ky shpenzim i qytetarëve të merret përsipër nga ekzekutivi, pasi që mundësitë buxhetore janë të kompletuara dhe janë shumë më të rritura se në vitet e kaluara dhe mund ta mbulonin edhe këtë shpenzim. Tjetra për të cilën do të diskutoj dhe për të cilën unë personalisht, gjatë katër viteve të kaluara, kam qenë shumë kritikues ndaj kolegëve të mi që në atë kohë kanë qenë opozitë dhe sot janë në pozitë, ka qenë se ata, në çdo takim, në çdo seancë pothuajse kanë kritikue se ne shtrojmë kubëza, shtrojmë rrugë me kubëza, rrugica, asfaltim, mure mbrojtëse dhe nuk bëjmë asgjë tjetër. Në bazë të listës së shpenzimeve kapitale për vitin 2024, siç e keni planifikuar, unë jam i bindur që edhe kolegët asambleist të cilët kanë qenë në katër vitet e kaluara me mu bashkë këtu, e kanë lexue dhe e kanë vërejt se prej 46 projekteve të cilat janë të planifikuara për vitin 2024, mbi gjysa janë të planifikuara për kubëzim. Për mu personalisht, absolutisht nuk çon peshë dhe nuk jam kundër. Unë jam për të mirën e qytetarëve dhe nëse është e nevojshme që të vazhdohet me kubëzime për qytetarët, duhet të vazhdohet. Mirëpo, ajo që më shqetësoi ma shumë është se disa projekte të cilat janë përfunduar vitin e kaluar dhe këtë vit, në bazë të informatave të cilat i posedoj nga qytetarët, janë duke u kryer në prona private. Unë nuk po muj ta di tash, pronat private janë pronë private edhe nuk duhet të përdoret buxheti i qytetarëve në prona private. Ajo pronë private shfrytëzohet vetëm nga Shpetimi dhe nuk shfrytëzohet nga qytetarët tjerë, ndërsa buxheti është i të gjithë qytetarëve. Po shpresoj të jem gabim! Nëse është e vërtetë, unë kisha kërkue i nderuar drejtor, apo pasi që kryetarin nuk e kemi as nënkryetarin, të marr ni përgjigje, a është e jashtëligjshme investimi dhe kubëzimi i këtyre rrugicave. Gjithmonë po tentojmë që janë rrugica private, jo publike. Me publike, natyrisht, aty ku është kërkesa dhe nevoja e qytetarëve duhet të vazhdohet me investime. Por, nëse janë private, kjo nuk është në rregull dhe është e jashtëligjshme, kundër Ligjit për menaxhim të financave publike. Do të kaloj pak edhe tek bujqësia dhe blegtoria. Natyrisht se bujqësi dhe blegtori është vazhduar buxheti i njëjtë, nuk ka ndryshime, nuk ka rritje. Sektorët kyç, bazë për zhvillimin komunal. Për rritje të punësimit janë këta dy sektorë dhe nuk po shoh aspak ndryshim edhe nga ana juaj, dhe po vazhdohet siç kemi vazhduar dhe ne në të kaluarën, duke e dërguar buxhetin vetëm në material të vdekur, në kubëza dhe betonim. Ju lutem, qytetarët po largohen, rinia iku. Sado që ne mundohemi me kubëza, me mure mbrojtëse, ata nuk po ndalen. Ne kemi nevojë urgjentisht ta ndihmojmë sektorin e bujqësisë dhe blegtorisë, t'i ndihmojmë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, t'u gjendemi pranë atyre, të ndikojmë tek ta që ata të ndikojnë tek punëtorët. Të ndikojnë tek qytetarët që janë të paktë, të cilët ende janë në pritje apo janë në hamendësi se do të qendrojnë apo do të largohen. Prandaj ju kisha lut, drejtor i Financave, pasi që kryetari nuk është këtu, ndryshone këtë buxhet pak dhe rritne buxhetin e bujqësisë dhe blegtorisë. Keni mundësi shumë ma të mëdhaja se ne në katër vitet e kaluara, buxheti është shumë më i madh se i joni, e di që rrogat janë rrit dhe shpenzimet, po prapë keni mundësitë e juaja shumë më të mëdhaja se ne që të ndikoni në këta dy sektorë. Besoj që do t'i merrni parasysh këto propozime të miat, unë kisha vazhduar edhe shumë më tepër të diskutoj për këtë temë, po po pres edhe një herë ta marr përgjigjen nga ana juaj, drejtor i Financave, dhe pastaj besoj që do replikojmë. Ju faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit, z.Hajredini! Dikush tjetër nëse do me e marrë fjalën? Fjalën e ka kërkue z.Mejzini nga LDK.

Sefidin Mejzini: Kryesues, faleminderit! Ju përsëritës të gjithëve të pranishëm! Përsëritës zyrtarin e OSBE-së! Shfrytëzoj rastin të ju uroj të gjithëve festën e Kurban Bajramit, të gjithë ata që na degjojnë edhe që na shikojnë! Tash unë jam në pozitë, po ka dalë këtu se, domethënë, çka na servojnë na veç me thënë amin. E kemi ni buxhet, deri në shtator ka kohë për me përmirësue. Te Lista e shpenzimeve kapitale, domethënë ku është ndërtimi i Ujësjellësit, 2 milionë edhe 500 mijë, 2,500,000, si ka mundësi me mungue fshati Buzez, prej të gjithë qetyre 16 fshatrave, nuk besoj se qendron ndonjëri ma keq se fshati Buzez. Edhe po habitem, domethënë kur është bo në fillim, qeverisjet e kalume nuk e di si e kanë lëshue këtë gabim, po edhe qeverisja tash nuk e di pse e ka lëshue këtë gabim. Domethënë është një fshat që ka vujt gjithmonë në të kalumen për

ujë, vuan tash për ujë, furnizimin e bëjnë prej lumit të fshatit Bresanë, ni reshje e shiut e bën ujin të papijshëm, iu shkakton probleme në amvisëri e gjithkund. Tash unë kërkoj nga qeverisja aktuale që të bëjnë të mundur si aneks ta shtijnë edhe ni fshat. Është për m'u habit edhe është... nuk e di, besoj që pajtohnu të gjithë me këtë, si ka mundësi me e lonë ni fshat që s'e kanë asnjë burim të vetin. Këto fshatrat tjera, nuk jam, është shumë mirë që ka fillue, ishalla ekzekutohet deri në fund, po nuk janë ma keq sesa fshati Buzez. Të jeni shumë të sigurt. Andaj kërkoj, edhe nga prej drejtorisë së Financave, edhe prej të gjithëve që ta mbështesim. Është e papranueshme. 2 milionë e 500 mijë edhe ni fshat të lihet është e papranueshme. Tash, te Lista e shpenzimeve kapitale, po filloj prej vendit ku edhe i kam marrë votat, këtu e mbrojmë interesin e të gjithë qytetarëve, pa dallime e ngjyra politike. Nuk jam i kënaqur me 23 mijë të ndame edhe me 15 mijë, për ni fshat që me infrastrukturë është ma dobët se të gjithë fshatrat përreth. Për fshatin Kosavë janë nda 130 e sa mijë vitin e kaluar, tash 7,497 për asfaltimin e rrugës Brrut-Zgatar, këtu është Kuk-Kosavë-Pllajnik-Kapre-Brrut. Rruga brenda në fshat qendron shumë keq, me asfalt, jo me kubëza, se kubëzat kanë fillue m'u shkatërrue. Nuk është parapa, vetëm 7 mijë euro për atë pjesën që është, nuk e di tash para kësaj ku kanë shkue, kanë shkue te rruga që është Zgatar-Blaç asfaltimi, nuk e di. Po fillojmë, drejtor edhe të gjithë të pranishëm. Ni kanalizim është jofunksional, domethënë në fund të fshatit. Ujnat e zeza derdhen në lum. Plus edhe ka çrregullime të ujrave të zeza te kanalizimi i fshatit Kuk, domethënë, se uji shkon teposhtë, s'ka ka me shkue, bjer në rrugë edhe nja 200 metër aty kundërmon erë e keqe. Domethënë këtu vjet është bo ni tentim, keni punue në fshatin Zaplluxhe edhe në fshatin Kapre, po në Kosavë e keni lënë se s'kanë dalë mjetet. Nuk po e shoh që e keni parashikue, ta keni parasysh. Mungon ni kënd i lojërave në fshat, besoj që fshatrat përreth e kanë. Ni stadium i futbollit të vogël mungon në fshat, fshatrat përreth e kanë. Stadium të vogël, siç e kanë krejt fshatrat, si t'ia nisish prej Blaçit, Zgatar, Brodosanë, Kuk, e s'po i përmendi, Bellobrad. Ndriçim publik nuk kemi, duhet me e pas parasysh. Dy rrugë, ni rrugë është për bjeshkë, ni rrugë që e lidhë fshatin në rrugë malore me Xërren, që është 920 metër, këto dy rrugët janë bo prej qeverisjes së kalume. Domethënë qe dy vjet nuk parashihni asnjë cent. Ajo e ka emrin rrugë e bjeshkës, po i prek gjitha pronat private. Ende s'është e kryme traseja e rrugës, 600 metër për me dalë nalt. Këtë pjesën tjetër e kemi lidhë me rrugën e fshatit Kuk, po nuk janë të kryta. Asnjë mjet s'e keni parapa. Edhe rruga që të thashë, 920 metër që e shkurton rrugën për neve për 7 kilometër për me shkue në Dragash, domethënë Kosavë-Xërxe-Shajne-Dragash, është përgjys sesa m'u sjellë kne, edhe aty s'keni parapa kurgjo. Ju kisha lut që t'i keni këto për bazë, që në ta ardhmen të boni diçka, se tash unë këtë buxhet dashta s'dashta duhet me votue, se është çështja e ujit, janë çështje tjera, tash nuk muj me penalizu pse s'keni investu në Kosavë, veç po ta kallxoj që infrastruktura është shumë dobët në krahasim me fshatrat tjerë. Unë i kam bo do foto gjatë punimeve të qeverisjes së këtyre, po s'është bo Paris. Jam mundue m'i kontrollue punimet që me bo punime sa ma të mira, por është shumë mangu me infrastrukturë. Edhe të ndërlihem te kolega Shpetimi që tha për kubëza. Ka shumë rrugë janë pa kubëza. Edhe për pronat private, unë e kam mendimin, përderisa ia marrim tatimin e pronës së shpisë, nuk ka shpi pa rrugë. Edhe bile 100% jau kemi rrit, jo këtu po është rrit tatimi i pronës. Tash na po jau marrim tatimin, e meritojnë edhe ni rrugë me pas. Edhe nuk ka shpi që bëhet nëpër pronën private, nëpër oborre, bëhet nëpër rrugë ku janë 5-6 shpia, e kanë rrugën, rruga është e ndame. Nuk ka aty, janë me numra, nuk besoj që është t'u bo nëpër oborr të dikujt këtu, janë rrugica. Faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit! Ni minutë replikë z.Hajredini.

Shpetim Hajredini: I nderuar koleg, ti e din që, po s'e di sa e kuptove edhe diskutimin tim. Nuk e pata qëllimin absolutisht për, si po i thue ti, kanë murin dhe rrugica është për 4-5 shpi. Edhe këto, nëse është pronë private, është pronë private. Për mu është pronë private, se unë s'kam me hi kurrë aty. Për mu është pronë private edhe unë s'due paren teme me ma çue aty. Plotësisht kjo është e padrejtë. Unë po e them për katër vitet e kalume, po të më kishte lejue ligji, unë në Kuk realisht edhe 70-80 vota i kisha pas. I kam hup për qet arsye, që s'kam tentue aspak me i krye edhe ato rrugica që po thu ti. As nuk janë në gjak, as nuk kanë të bëjnë ndërmjet vete, por janë në atë formë të përqendrume, që i kanë ndërtue shtëpiat që duhet me ia ndërtue edhe atyne atë pjesë të rrugicës, iu ka mbet domethënë pa kubëza. Po unë nuk e kam bo këtë. Kanë thënë do të thotë është e jashtëligjshme, ne nuk vendosim kubëza në ato prona. Unë e bëra shumë qart pyetjen, tash po them edhe kështu, shul-shqip, o janë shumë trima, o ata tonit s'e kanë ditë ligjin mirë. Njona është këtu, o këta të juajit janë shumë trima, p'i grahin, jashtëligjshëm p'i ndërtojnë, o ata tonit domethënë nuk e kanë ditë ligjin mirë edhe i kanë ndërtue rrugët. Po për mu, prapë po ta thom, sa të jetoj në këtë dynja, për mu ato prona janë private, se unë nuk

i shkeli kurrë po as ti s'kie m'i shkelë. Edhe pasuria komunale është e krejt qetyne qytetarëve të Dragashit, po edhe e krejt Kosovës, se me pare të qytetarëve tanë na s'un e kishna ndërtue asnjë rrugë. Po këto janë të krejt qytetarëve të Kosovës edhe për atë, për mu janë prona private. Okej, në rregull, unë nuk jam kundër, i thashë edhe ma herët drejtorit, që nuk jam kundër për me i plotësue kushtet të gjithë qytetarëve njëjtë. Se ma herët është vazhdue me aso kubëzime të cilat nuk kanë qenë të mira për mu personalisht, po me vazhdue atëherë duhet me vazhdue me të gjitha, mirëpo katër vite na i kemi ndalë. Edhe nuk i kemi krye këto, vetëm për hir të kësaj që është e jashtëligjshme dhe nuk kam tentue bile me shkue as me lyp ligjin, se më kanë thënë është e jashtëligjshme edhe e kam ndërpre aty. Nuk kam vazhdue ma tutje, se nuk e rrezikoj unë veten time me shkue në burg, për ty por as për kërkond tjetër. Edhe për mu, unë të thashë, le të vazhdojnë këta, le të kubëzojnë, absolutisht nuk jam kundër, do të ju mbështes, por prona private, nuk është në rregull, nëse është e jashtëligjshme, se do të keni probleme ma tutje me ligjin.

Uran Halimi: Faleminderit, z.Hajredini! z.Mejzini e ka kërkue ni minutë replikë edhe mbyllet çështja e replikës.

Sefidin Mejzini: Shpetim, shumë mirë në fund e përmirësove. Nuk jeni qe katër vjet që jeni konë, jeni konë 14 vjet në pushtet. Unë e kam të shtrume në vendin ku jam. Është pronë private po është e shtrume, prej qeverisjeve të kalume. Po unë po mendoj, përderisa jau marrim tatimin e pronave, na po jau marrim tatimin e pronës, edhe ata paret i kanë në qet komunë, se s'i kanë vetëm të miat e tuat, po i kanë krejt qato shpiat që janë, e kanë shkue edhe plemat bile i kanë tatimue. Edhe tash ku ka shpi pa rrugë? Helikoptera s'kanë ata, duhet me ec dikah. Faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit, z.Mejzini! Fjalën e ka z.Nedžmidin Sejdlar nga Pokret za Gora.

Nedžmidin Sejdlar: Të nderuar të pranishëm, fillimisht dua t'ju përgëzoj për festën e Kurban Bajramit. Në komitetin e mëparshëm të komunitetit, drejtori i financës, z. Kolloni, më ka mbet borxh për një përgjigje për një pyetje për ujësjellësin qendror. Zoti Kolloni, do t'ju drejtohem si person i ekzekutivit i ngarkuar për zgjidhjen e këtyre çështjeve. Sa i përket ujësjellësit qendror, në vitin 2024 keni buxhetuar 1,860,000,550 euro, ndërsa në këtë projekt keni buxhetuar edhe për shtatë fshatra nga rajoni i Gorës. Nga informacionet që kam nga terreni, mendoj se tashmë kanë nisur disa punime lidhur me këtë ujësjellës. Këtë informacione e kam marrë nga qytetarët e Vranishtit, të cilët janë të mërzhitur sepse edhe makineritë e rënda kalojnë nëpër pronën e tyre private. Në ujësjellësin qendror keni parashikuar edhe për fshatin Kukuljanë dhe më pas në një kolonë më poshtë keni parashikuar ndërtimin e ujësjellësit në fshatin Kukuljanë në vlerë prej 18 430 euro. Tani për mua është e paqartë, nëse Kukuljane është në ujësjellësin qendror, pse të ndërtohet sërish ujësjellësi në atë fshat. Unë supozoj se do të më përgjigjeni dhe nuk do të gabojmë. E treta, a keni zhvilluar debate me qytetarët nëpër fshatra për këtë projekt. I keni pyetur qytetarët nëse janë të interesuar të jenë pjesë e ujësjellësit qendror. E kuptoj që një pjesë e Opojes ka probleme me ujin dhe nuk jam aspak kundër kësaj. Mirëpo këtu në Gorë ka fshatra që i keni parapara në ujësjellës, ka fshatra që tashmë e kanë zgjidhur atë problem. Pse duhet të shpenzojmë tani dhe t'i përfshijmë në ujësjellësin qendror dhe përveç kësaj, të përfshihen në sistemin e pagesës të ujit. Kjo është një çështje që më shqetëson shumë si përfaqësues i popullit. Pres një përgjigje të saktë. Çfarë do të ndodhë me ato fshatra që nuk duan të lidhen me ujësjellësin qendror, sepse nuk kanë probleme me ujin e pijshëm. Dhe do t'i përfshini të gjitha ato fshatra në sistemin e faturimit? Me sa di unë do të ndërtoni vetëm rrjetin qendror. A nuk do të preken rrjetat e vjetra dhe as të rejtat nuk do të shtrihen nëpër fshatra. Si mendon se do ta zgjidhesh, se hera e fundit thate qe do te cosh tubin kryesor deri ne bazen e cdo fshati dhe kush te doje te lidhet, nese jo, jo. Nëse është kështu, ju sugjerojmë që të mos e bëjmë fare këtë punë sepse fshatrat që kanë zgjidhur problemin me ujin nuk duhet të përfshihen në ujësjellësin qendror dhe që këtë popullatë të mos i nënshtrojmë kosto shtesë. . Po kaloj në çështjen e ndërtimit të parkut në Dragash. Me rastin e të cilit keni alokuar 40.000 euro. Ju lus të më thoni nëse ky park nënkupton parkun që duhet të ndërtohet pranë varrezave dhe mbi varreza. Nëse ky është një park, atëherë këto 40,000 euro janë shumë. Është një vend i vogël dhe i ngushtë, dhe parku mund të rregullohet me 10 deri në 15.000 euro. Më intereson konkretisht të shoh projektin e atij parku. Si do të duket dhe ku do të shpenzohen ato 40 mijë euro. Komuna e Dragashit, komisioni për komunitete, kuvendi ka pranuar një peticion ku qytetarët e Dragashit duan të ndryshojnë lokacionin e atij parku, vetëm për arsye se po ndërtohet në varreza dhe afër varrezave. Thjesht ndërtimi i një parku pranë varrezave sipas traditës dhe njerëzimit tonë nuk duket mirë. Po kërkuj përgjigje konkrete dhe po kërkuj të shoh projektin

e këtij parku. Dua të di nëse do të ndërtohet vetëm parkingu apo vetëm parku apo pranë njëri-tjetrit. Këtë po kërkoj vetëm ta di sepse kam informacione se ju i paguani borxhet partiake përmes buxhetit të komunës së Dragashit.

Jetmir Ajdini: Përshëndetje për të gjithë! Urime festa e Kurban Bajramit të gjithë qytetarëve të Dragashit! Po kaloj direkt te Lista e shpenzimeve kapitale, planifikimi për vitin 2024-2026. Ma në fund po e shoh që është planifikue që të shtrohet rruga Brrut-Zgatar. Është një rrugë që ka fillue goxha moti edhe ka mbet përgjys, nëse është rruga që e lidhë fshatin Brrut me fshatin Zgatar edhe vazhdon për fshatin Blaç, nëse është ky projekt. A është ky projekt, drejtor? Po. Po e shoh që është planifikue ma në fund edhe ma në fund do të fillojë me ushtruar ajo rrugë, është një ndër rrugët ma të frekuentume edhe iu ka bo shumë telashe gjithë qytetarëve të komunës, qato fshatra që e frekuentojnë atë rrugë. Po e shoh që është ni vlerë diku 7500 euro, po janë të planifikume edhe kjo pjesa tjetër që janë për fshatrat tjerë, besoj gropat e këto me u rregullue. A do të realizohet në vitin 2023, apo është planifikuar për vitin 2024? A do të presin qytetarët edhe ni vjet që të kalojnë nëpër atë rrugë, e në vitin 2024 do të realizohet, apo do të fillojnë punimet edhe do të kryhet në vitin 2023, si pyetje për drejtorin. Edhe do të kaloj te projektet që janë planifikue për fshatin Zgatar. Është ndërtimi i kanalizimit, në vlerë 7 mijë euro. Është kubëzimi i rrugëve në fshatin Zgatar. Me na tregue pak çka përfshijnë qeto dy projekte, prej kujt janë propozue qeto dy projekte për fshatin Zgatar, domethënë çfarë kanalizimi do të ndërtohet në vlerë 7 mijë euro edhe cila pjesë e rrugëve do të kubëzohet me 10 mijë euro. Na e dimë që në Zgatar e kemi ni pjesë të rrugës në Gjerman, që është projekt përgjys, ka mbet pa përfundue, nuk e di kur do të përfundojë, është projekt që ka fillue goxha moti, vitin e kalum ka vazhdue ni pjesë edhe ni pjesë ka mbet përgjys, është e papërfundume. Mandej te kubëzimet që janë duke u bo në fshatin Zgatar nëpër rrugë lokale, drejtori bashkë me kryetarin kanë dalë në foto, i kanë bo pak reklamë atyre projekteve. Nuk e di a ka dalë mbikëqyrësi i punimeve me i pa ato projekte qysh janë t'u realizue. Firma ndërtuese është ni ndër firmat ndoshta ma të lodhta që ka punu në komunën tonë. Fillojnë diku, vazhdojnë diku tjetër, e lonë përgjys aty, vazhdojnë prapë diku tjetër. Është mandej rruga në familjen Murati, që është ni ndër rrugët ma të gjata lokale qaty që është t'u përfundu tash. Ajo rrugë ka fillue edhe ka vazhdue deri në gjys edhe është mbet në gjys, nuk e di a do të vazhdojë deri në fund të kryhet. Është diku edhe 50 ose 60 metër me përfundue, është përgjys, ka mbet në gjys qaty, domethënë nuk kanë vazhdue punimet ma shumë. Qajo pjesë është shtruar me kubëza, hala është e papërfundume. Me dalë me na i spjegue pak qeto edhe me na sqarue qysh kanë me rrjedhë punimet. Faleminderit! Edhe diçka, te kanalizimi, është projekt ku 7 mijë euro janë planifikue me investue në kanalizim, nuk po e di për cilën pjesë është fjala edhe kur do të ndërhyhet në kanalizim. Na e dimë që në fshatin Zgatar kanalizimi është bo para shumë viteve, është kanalizim jofunksional. Është gropa septike e ndërtume, mirëpo asnjëra prej kanalizimeve të lagjeve të fshatit nuk shkon e derdhet në atë gropë septike. Krejt qeto kanalizimet derdhen në lumin tonë, domethënë ni ndotje e lumit dhe ambientit. Nuk e di a keni planifikue me ndërhy në atë pjesën e kanalizimit. Gropa septike është e ndërtume para shumë vjetëve, ni pjesë e kanalizimeve derdhen nëpër ara dhe livadhe edhe kundërmojnë erë. Domethënë është kanalizim jofunksional. Nuk besoj që me ni vlerë 7 mijë euro mundni me funksionalizu edhe me i kyç krejt qato kanalizime, ku derdhen në ambient të hapur, me i kyç në gropën septike edhe me vazhdue mandej m'u bo derdhja në atë gropë septike. Faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit, z.Ajdini! Fjalën e ka z.Nexhat Selaj nga PDK.

Nexhat Selaj: Faleminderit për të gjithë! Përshëndetje! Po e shfrytëzoj rastin edhe unë të ju uroj Kurban Bajramin! Po më duket se, drejtor, në mungesë të kryetarit të kemi zonë sot ty. Ishalla na bojsh hallall dhe na japish sqarime! Do të ndërlihem drejtpërdrejt te Lista e shpenzimeve kapitale 2024-2026. Nuk po hi nga ajo e kaluara, se ndoshta keni qenë ma të akuzuarit, ma të zhurmshmit në çfarëdo debat, se qeverisja jonë 14-vjeçare është marrë vetëm me kubëzime. Nuk po hi aty. Po po shoh këtu se gjysma e ma tepër e parave po hudhen prapë në kubëzim. Po më vjen mirë që të paktën po e shifni vetë se kjo Komunë ka nevojë akoma për kubëzime, edhe për rregullime, edhe për sjelljen e standardeve jetësore të çfarëdo ekonomie familjare. Por jeni thirrë gjithmonë nga ajo se do të jeni parti e ndryshimeve, në aspektin e zhvillimit ekonomik. Unë në seancën e tretë apo të katërt të vitit paraprak, kam kërkuar që investimet pikërisht të kryhen, të investohet më tepër në bujqësi, krahas saj në blegtari edhe në lavërtari, se aty e kemi potencialin e tokave të cilat ne mund të investojmë. Nifare përlllogaritje të vogël, e kam dhënë një statistikë jozyrtare, për sa kam mujt të nxjerr, rreth 400ha toka publike, ara, dhe rreth 300ha a 250-300ha janë private, që kapin vlerën mbi 600ha toka me ara.

Është në pyetje për të mbjellurat. Unë në këtë projekt të juajin 2024-2026, nuk shof asnjë cent që ju keni afrue njerëzve të cilët dojnë të punojnë zonat fushore ose të mbjellurat. Nuk po hi nga ajo që të them prapë të kubëzimet, se ato do të bëjnë parandalimin e popullatës ose ikjen. Ikjen e bëjnë punësimet, drejtor. Unë e kuptoj se elementi i parë është rruga, në aspektin e zhvillimit ekonomik është rruga, por jo edhe të kubëzohen rrugët nëpër bjeshkë, e të lihen tokat të papunume. Fuqimisht do ta mbështes kolegën i cili foli pak më parë, edhe po më duket se po është ni frymë e demokracisë, e shkatërrimit të atij socializmi, të atij komunizmit, një me thonë po e të gjithë me e ngrit gishtin. Po më vjen se shumë mirë e cekti Sefa, që në qeverisjen paraprake, pikërisht për fshatin e vet, tha se diku rreth 920 metra, mos të gaboj, nga ish-Partia Demokratike në pushtet kur ishte janë investue, tash nuk është investue asgjë. Por e mbështes plotësisht edhe propozimin që e dha për fshatin Buzez. Ne jemi zonë e cila mund ta furnizojmë jo vetëm territorin tonë me ujë të pijes, por edhe gjysmën e Vrrinit. Unë vetë jam gjeograf edhe e di potencialin e sasisë ujore, sa sasi ujore kanë lumenjtë tanë, gravitojnë. Vetëm ujëmbledhësi i Lumit të Pllavës sjell rreth 6 metër kub ujë për sekond. Ne kemi një mori lumenj, sistem lumor, rrjedhës të cilët i bashkohen lumit, e të mbetet ni fshat, të ndahet nga ky sistem, ose unë po mendoj, po pajtohem me Sefën, mos është ndonjë gabim i përvjedhur, e nëse është, ka mbetur rastësisht kështu, ju kisha lut që ta shtini në program që të investohet edhe në këtë fshat. Ne do të kemi edhe gjëra të tjera të cilat duhet t'i flasim pak më vonë, por ni herë vetëm në aspektin e zhvillimit ekonomik. Faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit, z.Selaj! Dikush tjetër nëse do me e marrë fjalën? Fjalën e ka kërkuar z.Loshaj nga PDK.

Artan Loshaj: Përshëndetje për të gjithë! Zotni drejtor, shumë u diskutue rreth këtij buxheti. Unë shkurt, se na dy veç kemi diskutue në Komitet. E kam një pyetje: si do të investoni në pronat private, kur vendimi i ish-kryetarit, ekziston në zyrën e Urbanizmit, që nëpër prona private nuk kemi të drejtë të investojmë. Unë nuk jam kundër këtyre investimeve, se edhe ne kemi bo gabime, po është mirë ta shfuqizoni atë vendimin e ish-kryetarit, të merret ni vendim nga kryetari jonë dhe i juaji, e pastaj të investoni. Domethënë ju meniherë po boni shkelje ligjore, se aty është ni vendim që është i shkruar dhe i varur aty, që nuk guxon të bëni investime nëpër prona private, këtë e di shumë mirë z.Haxhisin, që ekziston aty ai vendimi i kryetarit. E dyta, mu po më intereson që në këto investimet në Stadionin e Dragashit, është shumë mirë, se jam adhures i futbollit, edhe ju përgëzoj në qoftë se bëhen këto investime, se është ni investim bukur i mirë, afër 160 mijë euro, por ta kam thonë edhe në Komitet, unë sa e di, ju nuk e di sa jeni të informuar, pak ta kam bo me dije që është ni vendim nga gjykata, atë vendim e ka Kuvendi, e ka kryetari edhe e ka Zyra Ligjore këtu që është, që nuk kemi të drejtë as Kuvendi Komunal, po as Sharrprodhimi të bëjmë investime derisa kjo pronë, ky proces gjyqësor të zgjidhet. Domethënë, edhe një herë ju thashë, është mirë që po investoni, po mos po bëni ndonjë shkelje ligjore, se aty nuk duhet të investohet. Është vendim i gjykatës, nuk është vendim i Kuvendit ose i delegatëve. Edhe ni pyetje tjetër e kam, që në këto projektet që na keni përqesh neve si PDK, që po bëjmë investime në kubëzime, po bëjmë investime mëdhaja, në të njëjtin avaz jeni t'u shkue edhe ju, se ju kam thonë edhe atë ditë, të njëjtit drejtor, të njëjtit punëtorë që kanë punue, krejt të njëjtit i keni, s'mundeni me bo ndryshime ju, se s'e keni shkopin magjik. Problemi është, ne kur kemi bo investime, bare i kemi...kur e kemi bo investimin e kemi shkruar në cilën pjesë, ju veç e boni në fshatin Rrenc 10 mijë euro. A rruga për te shkolla, a rruga për te stadiumi, a rruga për te...jo jo, veç e qitni këtu, domethënë ju, unë e di ku e keni, se sivjet keni bo do hapa shumë të shpejtë për kurse me e mbërrit 75%, me e marrë Grantin, ato investimet i keni bo shkel e shko, vitin tjetër do të shihen kubëzimet, do të shihen punimet e juaja. Edhe ju kam thonë, prapë edhe një herë po ju thom, e keni bo që 75%-shin ta boni, ta merrni buxhetin nga Qeveria edhe ato pare masanej ju t'i boni, qysh keni qef m'i bo, rrush e kumbulla.

Uran Halimi: Faleminderit, z.Loshaj! Dikush tjetër a do me e marrë fjalën? Fjalën e ka z.Driton Ademi nga PDK.

Driton Ademi: Faleminderit, kryesues! Përshëndetje për të gjithë! Drejtor, siç e thanë edhe kolegët tjerë, edhe unë pak po ndërlihem te investimet kapitale për 2024-2026. Po shoh qetu që veç janë dy fjalë: kubëzim edhe kanalizim. Asgjë tjetër hiç, veç dy emra jam t'u i pa. Në Bresanë unë s'e di ku doni me i çue 60 mijë euro kubëzim. Për çdo vjet ka 60 mijë - po foli veç për Bresanë ni herë, ma së pari - edhe 12 mijë euro kanalizim. Domethënë na e kemi miratue, kuvendet e mëhershme e kanë miratue, emrat e rrugëve. Po as në shtator të vitit të kaluet nuk i keni shkruar qeto, se ku kanë m'u shtruar kubëzimi, ose kanalizim, ose diçka tjetër. As vjet nuk e keni pas, se e kam edhe të vitit të kaluet. Po foli për stadiumin e Bresanës, nuk e di qetu te qekjo lista që na keni

pru sot, e keni shkruar 50 mijë euro, kurse vjet na e kemi miratue në buxhet, në shtator i kemi miratue 90 mijë euro për mbulojën e stadionit në Bresanë. Domethënë, edhe 90 mijë euro juve ju kanë shkue në suficit për shkak të OSHP-së. Nuk e di çka doni me bo në 2024-tën me 50 mijë euro, kur e keni shkruar, mos gabofsha, për brenda me rregullue në Bresanë, ndërtimi i dyshemesë, kurse hala është pa përfundue. Sivjet na i kemi nda prej të hyrave vetanake diku rreth 50 mijë euro, çka doni me bo sivjet 50 mijë deri vitin e ardhshëm, që doni dyshemenë me e bo. A ju e keni planifikue diku, tenderi mos gabofsha është 224 mijë euro. Për kulturë, rini edhe sport, domethënë 160 mijë euro kanë shkue veç për stadion. Kulturë, rini dhe sport veç stadionit ia keni nda. Po ku mbet fshati Blaç, domethënë, ku janë investimet e stadionit në fshatin Blaç, që i kemi nda na ato pare. A kanë fillue punimet, çka ka ndodhë me to, edhe a do të ndahen – ju e keni planifikue me e ndërtue atë stadion – nuk po shoh për 2024-tën asnjë cent për stadionin e fshatit Blaç. Edhe ni herë qet pyetjen, ose ka diçka lidhje teknike me stadionin në Bresanë, që e keni shkruar 50 mijë euro, kurse na i kemi nda 90 mijë euro në miratimin e buxhetit në shtator. Por ato, unë me sa e di, kanë shkue në suficit ato pare. Ose është ndonjë gabim teknik që keni bo, ose nuk e di çka është problemi. Faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit, z.Ademi! Fjalën e ka kërkue z.Agron Gashi nga AAK.

Agron Gashi: Së pari ju përshëndes të pranishëm! Përshëndetje për ju, kryesues, dhe për të gjithë ata të cilët janë duke na dëgjuar! Unë edhe në mbledhjet paraprake kam cekur se do të ishte mirë që kjo komunë, nëse i ka 35 fshatra, që të jetë një ndarje proporcionale të paktën, mos të ketë diskriminime, disa të privilegjuar e disa të diskriminuar. Nëse ju kujtohet, kam folur pikërisht për fshatin Bresanë. Shokët më herët folën dhe diskutuan për ato mjete 224 mijë euro, që veç janë ndarë për rregullimin e stadiumit apo sallës sportive. Mirëpo, duke hapur projekte të tilla të madhe, të cilat në fakt janë të nevojshme për qytetarët, për fëmijët tanë, ne duhet të bëjmë hapa ‘step by step’, si i thonë në atë kuptim. Do të thotë, në shumë fshatra mungojnë fushat, këndet e lojrave mungojnë, mund të thuash plotësisht se gjysma e fshatrave të trevës tonë nuk kanë në dispozicion asnjë kënd më të thjeshtë për të luajtur. Ndërsa këtu mjetet shihet tashti se duhet palestra të shtohet, me të gjitha ato pajisje të cilat duhet t’i ketë një sallë, por në anën tjetër mos të harrojmë se s’kemi kënde lojrash për të tjerët. Fshati Brezne menjëherë prin mas Bresanës, mirëpo asnjë fushë sporti të paktën ma elementare nuk e ka, që fëmijët të gëzojnë të drejtë. Dhe duke u nisur nga ky parim, është dashur që të bëhet hapi i parë, mos të kalojmë te hapi i dytë, sepse sporti është i ndijshëm. Talenti i fëmijëve është i fushave të ndryshme. Një fshat të disponojë dimër-verë, të luajë dhe i bëjë ushtrimet fizike, dhe të avancohet në atë drejtim dhe të jetë më i ngritur dhe te ketë një talent më të mirë, do të jetë ma i avancuar. Mirëpo, në anën tjetër, fshatrat tjerë edhe fëmijët e tjerë, mund të thuash plotësisht se është një diskriminim total që është dashur të jeni më të korrigjueshëm në këto ndarje buxhetore, sepse kjo komunë thith mjete nga të gjithë këta qytetarë. Edhe një tjetër që desha, ndoshta nga personeli kush është kompetent në këtë komunë, unë kisha kërkuar veç një gjë, ama edhe tash ndoshta nëse ka kohë, të shkojë në zyrën adekuate ku duhet, të merr dhe të nxjerrë pak shënime, vetëm në dhjetëvjeçarin e fundit, të shohin se sa para janë investuar në Bresanë dhe sa në fshatra të tjerë. Edhe unë ju garantoj se do të shihni një disproporcion i shkeljeve flagrante të të drejtave të qytetarëve. Do ishte mirë një korrigjim më i mirëfillt në këtë drejtim. Faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit, z.Gashi! Dikush tjetër a do me e marrë fjalën? Faleminderit, z.Gashi! Faleminderit Driton që u interesove për dajët atje në Blaç! Deshta ta plotësoj z.Gashi, në lidhje me fshatin Brezne, po e shoh ni shumë goxha e madhe, 128 mijë euro. Po më vjen shumë keq që për fshatin Blaç, thashë edhe në Komitet kam folë atë ditë, që është folë edhe u diskutue goxha shumë për votimin edhe ndërtimin e stadionit në fshatin Blaç, thojshin që s’është i fshatit Blaç po po ndërtohet në Blaç. Ju e dini shumë mirë. Masi i bojme 27 vota edhe zero kundër, e shoh që fshati Blaç penalizohet, i ndahen veç 10 mijë euro për ni projekt të qeverisjes së PDK-së, i cili prapë po vazhdon me mbet vetëm në letra. Gjendja e stadiumit, krejt qytetarët me pyesin, realisht, çka është t’u bo edhe çka është t’u ndodhë me stadiumin. Janë arsytue që ka të reshura me ni seancë paraprake. Realisht, u luta, thashë ishalla nalën të reshurat e të vazhdojnë punimet, veç due me ju thonë që klubi KF ‘Opoja’ vjet në këtë kohë kanë mund me bo ushtrime në stadiumit e fshatit Blaç, kurse sivjet është ai vendi krejt i shkatërrim, krejt baltë realisht. Punimet s’po vazhdojnë, qytetarët po pyesin. E shoh që për këtë periudhë 2024-2026 te fshati Blaç prapë janë të ndame 10 mijë euro për ndërtimin e parkut, ne jse 13 e paskan bo qetash, s’i kanë nis ato me 10, që u konë i parvjetshmi. Janë shtue 3 mijë euro, po s’po fillon kurrgjo, mundeni me ia shtue edhe nja 3 mijë tjera, nëse s’e filloni, 10 mijë bile shtonja, po duhet me fillue ajo. Tjetra është rregullimi

i kaptazhëve, që e kam bo ni kërkesë para votimit të buxhetit vitin e kalum, prapë kongra i njëjti, kurgjo e fillume, kurgjo e realizume. Po vazhdoj në shëndetësi. Realisht, z.Loshaj vazhdimisht ankohet për kushtet jo të mira në QKMF. Krejt qytetarët e dinë qysh janë kushtet në QKMF, e është nda ni pjesë goxha e madhe e të hyrave ose e mjeteve, ku aty mungojnë edhe barnat esenciale. Domethënë gjithçka mungon aty, pare plotë. Po e shoh në Drejtorinë e Administratës, përveç pagave që janë 300 mijë euro, janë edhe 350 mijë euro mallra dhe shërbime, të ndara, të planifikume 350 mijë euro për mallra dhe shërbime, nëse mundesh drejtor me na sqarue kah, qysh, kur e dimë që ne si delegatë po vazhdojmë vitin e dytë, gati edhe të tretë të qeverisjes me mungesë të llap topëve. Ato premtimet që na i kanë dhonë po më dalin sikur premtime në fushatë kur bëhen. Te ndërtimi i kanalizimeve, unë realisht po lëndohem, se në fushatë është përmend ni gropë septike, rifunksionalizimi e rivitalizimi i asaj që është e ndërtume edhe e lënë pezull. Kanalizimet ku doni more me i çue, mu qekjo po më habit, ku e çojmë kanalizimin, në lumë a? Vazhdimisht luftohet për mbrojtje të ambientit, drejtori me atë kompaninë e pastrimit vazhdimisht e pastron do rrugë, e do foto i kam pa drejtor, përgëzime për atë, rrugët janë pastrue, Na s'mundim me ndërtue diçka e me shkatërrue diçka të ndërtume, a po kupton? Kanalizimet ku kemi bre me i çue, është e ndalume kanalizimi në lumë me qit. Realisht edhe fatkeqësisht, krej kanalizimet i kemi në lumenj, kjo është për me të ardhë keq. Fshati Blaç, për shkak të atij stadiumi që ka mbet pezull edhe i shkatërrum, përveç asaj që pezull, është i shkatërrum, ma keq se qysh u konë, ka hup edhe interesimi i investitorëve, se e kanë pa që çështja është joserioze. Ma herët kemi pas ni donator nga jashtë që ka premtue ni shumë goxha të madhe të mjeteve për stadiumin e cili po ndërtohet në fshatin Blaç. Kohën e fundit jam t'u e vërejt që nuk ka mo interesim të kërkujt, se normal është diçka joserioze. Më vjen shumë keq, ndoshta fshati Blaç ka mbet me nja 10-12 mijë euro, se kjo qeverisje po e shpërblen fshatin Blaç me do punësime partiake, kjo është e mirë, po duhet pak edhe ta ndërtojmë. Fshati Blaç ka goxha këtu në ekzekutiv njerëz, që është turp me e lonë me...është prej fshatrave ma të mëdhenj të Opojës. Mos qoftë te të parët, është dy-tre. Sidoqoftë, është ai mesi i artë e neve po na radhitni me buxhet te fundi. Kështu që, është mirë me u kthjellë, unë personalisht nuk e mbështes këtë Kornizë, duhet goxha ndryshime edhe goxha kujdes në ndarjen e këtyre mjeteve. Është mirë me e thirrë atë përpiluesin e kësaj Liste, me na tregue cilat janë kriteret që janë shfrytëzue për përpilimin e kësaj Liste, me na dhonë pak sqarim. Faleminderit shumë! Po vazhdojmë. Përveç asaj, që më mbet edhe diçka peng, i kemi zgjedhë këshillat e fshatrave, asnjë takim s'e kanë bo ata këshilla të fshatrave me qytetarë, edhe këto mangësitë të cilat janë në këtë Listë, unë po besoj që janë edhe pasojë e mospunës së atyre këshillave. Kjo Listë u dashtë m'u përpilue me kërkesat e qytetarëve. Është për m'u çudit, në fshatin tem po foli, për fshatin tem po edhe të gjithë fshatrat në tërësi, jam shumë i sigurt që asnjë rej këtyre kërkesave bon vaki s'e kanë bo ata këshilla bashkë me qytetarët e fshatrave. Kjo Listë duhet m'u përpilue prej qytetarëve. Kërkesat e qytetarëve, jo të dalim na këtu edhe të flasim secili asambleist për vendin e vet, se po më vjen shumë e ulët, na duhet me folë në përgjithësi për tema goxha më madhore. Mirëpo, Lista që u përpilue pa pyetjen e qytetarëve edhe të këshillave të fshatrave, nuk është për m'u përkrahë. Faleminderit shumë! Nëse do dikush tjetër me e marrë fjalën? Atëherë, e pashë që shumë pyetje janë bo direkt te drejtori i Ekonomisë dhe Financave, përgjigje munden me dhonë kushdoqoftë nga ekzekutivi, s'është patjetër drejtori i Ekonomisë dhe Financave. Kushdoqoftë nga ekzekutivi, kushdo që e përfaqëson kryetarin në mungesë, është mirë me dalë edhe me dhonë përgjigje. Ju ftojme të nderuar që ta merrni fjalën. Kush po e do fjalën nga ekzekutivi? z.Qamil Kolloni.

Qamil Kolloni: Përshëndetje, kryesues! Përshëndetje delegatë, urime të gjithëve festa e Kurban Bajramit! Unë kam kënaqësinë, po më vjen keq se sot nuk është kryetari, kam kënaqësinë se dëgjova shumë pyetje me vend dhe shumë pyetje të mira të cilat i parashtruat. Po deshta që mos ta harroni se ky është leximi i parë dhe deri në shtator do t'i definojmë secilin projekt veç e veç. Kryesues, ndoshta u desht që i fundit të marrësh përgjigje, po po të jap të parit. Pikërisht mas konsultimit me këshillat e fshatrave do t'i definojmë secilën. Ne i kemi ndarë mjetet të cilat i kemi në dispozicion, si hap i parë që është dashtë në mënyrë të domosdoshme me e bo. Pjesën tjetër do ta bëjmë me të gjithë këshillat e fshatrave. Për këtë arsye na kemi dhënë nifarë sqarimi, në të cilin kemi thënë se 4 milionë euro kemi në përgjithësi investime kapitale. Nga këto 4 milionë eurot ka afektue Ujësijellësi kryesor që biseduat të gjithë në vazhdimësi, me 2 milionë e 500 mijë euro. Të gjitha projektet të cilat kanë qenë – po mundohem t'ju jap në mënyrë lineare një përgjigje për disa pyetje të njëjta që i keni bo – janë edhe projekte që nga viti 2021 kanë afektue deri në vitin 2023, dhe kur bini në nivelin e lokalizimit të fshatrave, janë edhe ato projekte të cilat kanë qenë në fshatin Bresanë të parapame që në vitin 2021 dhe kanë

afektue deri në vitin 2023. Shumë herë kam diskutue këtu se nuk mund t'i lejojmë mjetet të cilat janë parapa në shuma të vogla që të na shkojnë në suficit dhe kemi intervenue edhe na si qeverisje, e kemi marrë përgjegjësinë e qeverisë së kalume, nuk e kemi akuzue po kemi marrë përgjegjësi, dhe aty ku ka mungue buxheti, për mos me i kthye prapë, na kemi intervenue dhe nuk e kemi lonë pa intervenue. Të njëjtën situatë e kemi pas në fshatin Bresanë, të njëjtën situatë e kemi pas në fshatin Kuk edhe në rrugën e fshatit Kuk, që deri këtë vit është projekt i qeverisë së kalume, dhe na nuk jemi ankue po kemi luftue me bo zgjidhje. Besoj se do të bëjmë zgjidhje, për arsye se jemi qeveri e përgjegjshme dhe i kemi marrë përgjegjësitë dhe nuk kemi marrë ankesa. Faleminderit për shumë pyetje me vend! Do të filloj, në qoftë se harroj ndonjë rastësisht prej delegatëve, ju kërkoj falje paraprakisht. Do të filloj me Shpetim Hajredinin. I nderuar delegat, shpenzimet për shërbime komunale janë shpenzime të cilat janë rrit, mirëpo pikërisht në pyetjet tjera në vazhdimësi, ju folët për kanalizimet, na kemi intervenue prej mallrave dhe shërbimeve nëpër shumë kanalizime dhe realisht kemi parapa që po na paraqiten shumë kërkesa, që tash pikërisht në këtë fazë jemi në përgatitje të projektit për fshatin Kuk edhe Kosavë, i cili na ka dështue projekti i mëhershëm i kanalizimit, nga mallrat dhe shërbimet për me bo zgjidhje edhe me bo sanim. Sepse nuk po na pret neve me e pa na kur jemi të gatshëm me planifikue për me bo. Dëmi po ndodh atëherë kur po ndodh dhe po duhet me intervenue atëherë kur po duhet me intervenue. Gjithashtu e kemi edhe projektin e fshatit Zgatar edhe në Zaplluxhe, po afektojnë dhe nuk kemi mënyrë të ndryshme, ligjore, për me mund m'i sanue këto probleme që po na paraqiten pa planifikue, dhe kemi krijuë vitin e kaluem ni strategji që nëpërmjet mjeteve për mallra dhe shërbime t'i kryjmë edhe disa investime kapitale që realisht janë të detyrueshme. Sa i përket pronave private, Shpetim thatë se po investoni në prona private. Të drejtën me të thonë, si qeverisje lokale kemi hasur ni dukuri nëpër fshatra, ku ni numër i qytetarëve ankohen për moskubëzim, për çështje politike, çpolitike, pa hy në detaje, kemi ardhë në një qëndrim se janë shumë pak mjete për komunën që t'i rregullojmë edhe ato probleme, edhe ato ngatërresa, t'i ikim përçamjeve, të vijmë në një moment kur mo nuk do të kemi përçamje edhe nëpër fshatra, do të ishte mirë edhe për LDK-në edhe për PDK-në edhe për subjektet tjera. Na kemi kërkuë që të gjitha ato prona, përmes noterit, të barten si prona publike që të mund të kubëzohen, për shkak se kemi qenë të njohur me vendimin paraprak të Kuvendit Komunal në Dragash. Shumica e investimeve të cilat bëhen, bëhen nëpër pronë publike, pasi të bëhet marrëveshja me noterizuesin. Sa i përket sektorit të bujqësisë dhe blegtorisë, po të njëjtën pyetje në vazhdimësi e kemi bo. Në qoftë se dikush mendon se kush do të ishte ithtari numë një që të ndryshojë filozofia e investimeve kapitale edhe e investimeve për zhvillim ekonomik në Komunën e Dragashit, detyrimisht do të kisha me qenë unë. Jo që këtë filozofi kam tentue ta ndryshoj tash, por kam luftue ta ndryshoj edhe kur kam qenë në vendin e juaj si delegat. Mirëpo, janë kushtet dhe kriteret të cilat ndikojnë. Sa i përket investimeve kapitale, na kemi ndryshue ni strategji, ku kemi shkue që përmes infrastrukturës t'i ndihmojmë blegtorisë, që na lejohet, me hapjen e rrugëve për bjeshkë, kurse nëse ke mendue se të intervenohet drejtpërdrejt në subvencione, në bujqësi, ti Shpet e dish me mu ma mirë, se për subvencionim direkt komuna në bazë ligjore mund ta bëjë prej të hyrave vetanake dhe jo nga Granti qeveritar, për arsye se subvencionet të cilat i bën, si në infrastrukturë, gjithashtu edhe në subvencione direkte, i bën qeveria. Në investimet kapitale janë këto mundësi që kemi parapa, përmes rrugëve ta kompensojmë këtë investimin në bujqësi. Kjo është strategjia jonë, ndoshta mund të jetë e gabume, mund të ketë dikush edhe ndonjë strategji ma të mirë, po na kaq kemi ditë, kështu kemi veprue. Sa i përket subvencioneve të drejtpërdrejta, se pata edhe një pyetje në subvencionimin e të mbjellurave, ju vitin e kaluar e dini se për herë të parë prej qeverisë i është mundësue, me kërkesën e Komunës së Dragashit, që ato pak të mbjellura janë subvencionue. Tash kemi bo kërkesë që qeveria të subvencionojë, mundësisht të lejojë edhe livadhet, për arsye se s'mund të kërkojë subvencionimin e grurit edhe të misrit në Komunën e Dragashit, kur kie rendimente tepër të ulëta edhe në nivelin e mundshëm dhe të mos subvencionohen kur shumica ose mbi 90% e tokës është bar, që detyrimisht i nevojitet blegtorëve për bujqësi. Mirëpo, këtë kompetencë nuk e ka. Nga të hyrat vetanake të cilat i kemi realizue, në subvencione hyjnë edhe të gjitha aktivitetet që i bëjmë me OJQ-të, me Klubin Futbollistik që e mbajmë, me aktivitetet kulturore që i zhvillojmë, dhe realisht mundësia për intervenim të drejtpërdrejtë në subvencionimin e bujqësisë është tepër e limituar. Duhet ta kesh parasysh se ka edhe ni vendim për shfrytëzimin e të hyrave nga tatimi në pronë. E hyra nga tatimi në pronë është e dedikuar qind për qind të kthehet në investime kapitale dhe na e përdorim edhe për subvencionim të bujqësisë dhe blegtorisë, ose edhe për aktivitete tjera, për faktin se nuk kemi të hyra të tjera të mjaftueshme që t'i

zhvillojmë këto aktivitete. Këtë problem e ka pas edhe qeverisja paraprake, këtë problem e kemi edhe na. Sefidin Mejzini, investimet në ujin për fshatin Buzez, me sa kuptova që nuk është e parapame. Na si qeverisje lokale e kemi gjet ni projekt të tillë, projekti ka qenë i parapamë këto 15 fshatra. Na nuk kemi mund me bo shtimin e numrit të fshatrave, kemi bo revidimin ku janë paraqit problemet, se ju e dini se problem i këtij ujit të 15 fshatrave është ni problem thujse ndërkombëtar mo, nuk është veç i Komunës së Dragashit. Lufta dhe përpjekja jonë ka qenë që na t'i tejkalojmë barrierat të cilat kanë pengue deri tash në aspektin administrativ, që të mundim të lidhim ne kontratë. Falë Zotit ia kemi arrit që ta lidhim ni kontratë me tre operatorë, dhe ju e dini se për këtë vit nuk kemi mund me planifikue mjete ma shumë, për arsye se nuk e kemi ditë a do të mund ta tejkalojmë OSHP-në dhe të lidhim kontratë, dhe kemi nda mjete vetëm 500 mijë euro sepse nuk e kemi pas vendimin përfundimtar të OSHP-së në momentin kur kemi planifikue buxhetin për vitin 2023. Dhe çka ka ndodhë, për mos me rrezikue me lëshue na 1 milionë euro, me parapa për këtë vit, kemi parapa 500 mijë euro, se kemi thënë në qoftë se nuk arrijmë ta tejkalojmë këtë problem administrativ, ma mirë është që 500 mijë euro të na shkojnë në suficit sesa të shkojnë 1 milion ose 2 milionë euro, sa ka qenë komplet projekti. Sepse ni problem të tillë qeverisja paraprake ka humb 4 milionë t'o dështue për 10 vite në këtë projekt, janë kthye në suficit. Tash nuk kemi desht qaj problem të na paraqitet edhe neve. Na për fat të mirë edhe këto 500 mijë eurot nuk po na kthehen në suficit, kemi lidhë kontratën, ni operator ekonomik ka fillue punimet nëpër disa fshatra, ku disa qytetarë në fillim na janë ankue, tash janë tërhek prej ankesave, se uji është ma i rëndësishëm se të gjitha, janë prona tepër të vogla, probleme tepër të vogla që Komuna në bashkëpunim me menaxherin e projektit po i tejkalon në vazhdimësi edhe ato pak barriera. Sa i përket Buzezit, jemi në diskutim e sipër, në qoftë se Kuvendi vendos, edhe mund të gjendet një zgjidhje teknike, na si qeverisje nuk kemi ni zgjidhje teknike për momentin. Nuk është problemi që të inkorporohet në këtë projekt, por kjo mbetet që të diskutohet me njerëz të cilët e njohin dhe mos të bëjmë dëshira ose propagandë politike këtu, të thona po ose jo. Në qoftë se na vjen, na konstatohet se mund edhe është e realizueshme edhe gjendet një model për realizimin, pse jo, do ta shtimë edhe fshatin Buzez, realisht fshati Buzez, po nuk është fshati Buzez, operojnë një numër i operatorëve ekonomië që asnjëri nuk është nuk është pronar i atij fshati dhe ata veprojnë e nuk kanë ujë të mjaftueshëm, po edhe nuk guzojmë t'i lëmë ata operatorë ekonomikë që të shfrytëzojnë ujin e pijshëm për zhvillimin e industrisë edhe punëve të tyre, sepse uji i pijshëm është edhe i kushtueshëm. Sef, ti bone disa pyetje që unë nuk do të kisha dashtë me t'u përgjigj, do të ishte mirë t'i bëje në rrethana të tjera, po unë jam këtu drejtor i Ekonomisë dhe Financave. Buxheti që përdorim ni formulë për kokë banori, sa i përket investimeve kapitale, masnej në disa raste unë nuk jam ithtar i asaj se detyrimisht në fshat tim të investohet, ose duhet në një fshat të investohet, po ne kemi shkue me logjikën të investojmë aty ku nuk mund t'i humbim paret, se dy vjet është bo nifarë riparimi i buxhetit, në qoftë se e kuptosh. Sepse kemi gjet ni numër të madh të projekteve dy-tri vjeçare të cilat detyrimisht kanë afektue në buxhet. Nuk kemi mund me planifikue dhe e kemi lënë strategjinë që është fati ma i mirë ndoshta, se të gjitha këtyre fshatrave që iu kemi lënë sa ma pak investime të planifikume, shpresojmë se do ta marrim edhe Grantin e performancës, për arsye se të gjithë parametrat i kemi përmbush, dhe në pranverë, kur të bëjmë shpërndarjen e buxhetit, do të mundohna që këto fshatra që i kemi lënë ma me pak investime kapitale, t'jau shtojmë edhe ni shumë të investimeve kapitale dhe pak a shumë të bëjmë nifarë bilanci. Shpresoj që edhe atë do ta arrijmë. Ju duhet të jeni të informuar se ka ardhë raporti i auditimit të jashtëm ekselent, që asnjë vjet të tillë nuk e ka pas Komuna e Dragashit. E keni tashmë edhe draftin përfundimtar. E keni vërejt se raporti për transparencë është ngrit për dhjetë vende, janë raporte të cilat na vlerësojnë punën tonë të qeverisë për 2022-tën. Janë faktorë kredibilë. Gjithashtu, raporti për integritet evropiane është pozitiv dhe gjithashtu edhe shumë punë të tjera janë bo, që garantojnë për një grant të performancës shumë solid, t'u pas parasysh se edhe me investime kapitale jemi me 86%, kurse me shfrytëzim të buxhetit jemi me 94%. Kjo është një ekselencë për Komunën e Dragashit, që i ka ndodhë pas 22 viteve. Kjo nuk ka ndodhë, nuk po e them mo me modesti, janë të dhënat faktike që jeni të gatshëm t'i lexoni në uebfaqe të komunës secili delegat. Këto mjete, ky Grant do të jetë goxha solid që do të mund të intervenojmë në këto fshatra. Prandaj, duhet të kemi pak durim, duhet të shohim ku mund t'i orientojmë paret ma mirë, ku janë ma urgjente e kështu me radhë. Sa i përket kanalizimit, këndit të lojrave, stadionit të vogël në fshat, Sefo në përgjithësi, nuk dua të hyj veç e veç, po mendoj se... Nedžmidin Sejdilar, Ujësjiellësi kryesor. Nexho, faleminderit shumë! Uji kryesor është brengë për të gjithë neve, po thuesh në këto fshatra a është bo dëgjimi publik. Ky projekt është bo në vitin 2012-2013, mos

gabofsha. Tash prej atëherë ka fillue, ky kur është nis veç si projekt janë investue disa qindra miliona euro dhe ka mbet si i tillë, pezull. Na e kemi gjet si të tillë, si projekt të vazhduar dhe vazhdojmë me të njëjtin projekt. Unë besoj, nuk jam i sigurt, po besoj se është bërë në konsultim derisa është bërë ky projekt, është bërë në konsultim me ato fshatrat edhe njerëzit kanë shprehë interesimin e vet, dhe për atë arsye ka fillue, se nuk mund të fillojë në projekt madhor 4 milionë euro pa u konsultue me qytetarët. Çka do të bëhet me ato fshatra të cilat nuk duan të jenë pjesë e këtij Ujësjiellësi – njëra prej pyetjeve. Unë mendoj se, në bazë të projektit, menaxherët dhe operatorët ekonomikë do ta realizojnë ashtu si është i paraparë. Në qoftë se fshatrat heqin dorë, na dhunshëm nuk mund t'i shtimë që të jenë pjesë e ujit. Po po ju jap, edhe ni pyetje për kanalizimet që po e boni shpeshherë, t'ua jap edhe ni sqarim. Ne kemi bërë ni kërkesë në Bashkimin Evropian për ndërtimin e impianteve dhe kanalizimit kryesor në tërë territorin e Komunës së Dragashit. Në bashkëbisedime kemi qenë unë, Bean Hadziasan, edhe kemi angazhue ni konsulent për trajtimin e ujrave të zeza pranë BE-së, Skender Bublakun. 22 milionë euro, të gjithë investimin e merr Bashkimi Evropian, për rregullimin e kanalizimit dhe impianteve në momentin kur qytetarët e Komunës së Dragashit janë të regjistruar në pagesën e ujit. Na është thënë në mënyrë decisive, kanalizimi është autostrada e ujit. Derisa ju e shfrytëzoni ujin pa pagesë, nuk e paguani ujin, nuk ka ndërtim të kanalizimit edhe të impianteve kryesore. Prandaj të gjitha investimet lokale që po bëhen në kanalizim, janë investime që vetëm po i pastrojmë fshatrat edhe po mundohna me e bo ni zgjidhje provizore. Prandaj na është shtruar dhe pyetja që disa fshatra të komunitetit goran, në momentin kur do të ndërtohet ky Ujësjiellësi i përgjithshëm, që detyrimisht do të afektojë për shkak të mirëmbajtjes, se është tepër projekt i madh, duhet të paguajnë dhe të participojnë në ujë, kanë shprehë që nuk do të jenë pjesë e pagesës. Dhe këtu do të na dalë një defekt tjetër edhe kur do të realizohet ky ujë. Mirëpo, kriteret, ligjet dhe standardet evropiane kërkojnë një sjellje krejtësisht tjetër dhe unë mendoj që me kohën edhe qytetarët do të vetëdijesohen, edhe do të arrijnë edhe këtë çështje ta tejkalojnë. Sa i përket parkut pranë ose tek varrezat. Nexho, kemi shërbimin që përmes Gjeoportalit edhe e shohim. Në qoftë se janë varreza, na nuk jemi të çmendur që në varreza me ndërtue ni park. Është ni park për fëmijë që ma shumë do të pajiset për që të luajnë fëmijët e Dragashit edhe të kenë ni vend rekreativ, nuk ka të bëjë këtu kurgjo më ndonjë problem tjetër. Në qoftë se nuk shprehin vullnet që të bëhet ky park, nuk do ta bëjmë. Kundër qytetarëve as nuk kemi shkue, as nuk kemi ndër mend të shkojmë. Në qoftë se flasim për politikë, mos bini në nivelin për ni grusht vota, se jeni më të dijshtëm sesa për ni grusht vota, dhe mos bini në nivelin për ni grusht vota, se po e ulni atë aftësinë e juaj. S'po kam dëshirë me ju pa në atë gjendje. Jetmir Ajdini, ndërtimi i rrugës Brut-Zgatar 2023. Po Jetmir, rruga do të ndërtohet sivjet, do të ndërtohet edhe me paret e atyre fshatrave që kanë qenë pjesë e projektit dhe tash do të dalin, sepse është ma e rëndësishme ajo. Pse është vonue? Nuk është vonue pse e kemi vonue na, po është vonue se ajo rrugë ka qenë e fillume, po nuk ka qenë komplet. Ni pjesë ka qenë e ngushtë, kemi ra në marrëveshje, na është lëshue rruga, kemi bo murin dhe u desht detyrimisht me prit derisa të piquet muri. Bageri është aty edhe ka edhe ni afat të inxhinierave për me fillue punimet, kontrata është e nënshkrue, këto veç fillohen ato punimet, dhe unë jam qaj që kam thonë le të kryhet kjo rrugë, se na e dimë që është ma e frekuentume. Jemi në këtë gjendje ku jemi dhe ajo rrugë ka me u ndërtue, kismet prej Zotit. Është një firmë prestigjioze që e ka nënshkrue kontratën, edhe presim që edhe kjo rrugë të ndërtohet. Por, ju lutem shpeshherë, prapë po ju lutem, është mirë kur kritikoni edhe shumë në rregull, se nuk ka demokraci të vlefshme pa kritikë. Po mos bini në kundërshtim me vetveten. Në momentin kur po e shprehni lokalizimin e juaj, mendoni pak edhe për lokalizimin e rivalit politik. Prandaj këtu është çështja që kjo rrugë, kismet Zotit, Jetmir, do të ndërtohet sivjet, kontrata është nënshkrue, pritet të fillojnë punimet, Renelual Tahiri është ni firmë shumë serioze. Është mirë që është gjet edhe zgjidhja, është zgjerue ajo rruga, se ti e dish që në fillim ka qenë tepër e ngushtë, edhe shpresoj që ajo do të kryhet. Sivjet, veç është nënshkrue kontrata. Sa i përket kubëzimeve në Zgatar, na kemi nda mjete edhe kubëzimet, mas këshillat e fshatrave kur do të diskutojmë, ju do t'i përcaktoni, na nuk i përcaktojmë, na e kemi nda shumë e mjeteve. Dëgjo, fole për ndarjen për vitin 2024. A për sivjet që kanë fillue punimet, ato veç kanë fillue, dihet ku është t'ua bo projekti, se shkrun edhe emri i projektit. Ndërsa disa pjesë që janë ndërprerë, dimë se dikush i ka nalë aty për shkak të pronave, pronësisë. Sa i përket Gjermanit, kemi marrë qëndrim ni herë t'i kryjmë brenda nëpër fshat ku janë kërkesat, masnej dalim në Gjerman. Çka të mbesin, dalim edhe përpjet, s'është problem, Gjermani mund të bëhet edhe me ndonjë donacion, këto brenda fshatit janë pak ma problem, sepse na kemi konkurue edhe me disa projekte në Ministri, për donacione, edhe besoj se këto qendrat ku janë qendra turistike, kanë mundësi të

merren edhe donacione të ndryshme dhe është ma lehtë, dhe ndoshta bëhen rrugë më të mira për këso pika turistike, sepse ti e dish që Gjermani është njëra prej zonave në PZHK si zonë turistike. Nexhat Selaj, ju për bujqësi ma merr mendja se dhashë edhe për ju përgjigjen, kur thashë se ni pjesë sa i përket bujqësisë edhe blektorisë, ni pjesë e mjeteve, se janë dy kategori, do të thotë investimet kapitale edhe subvencionet. Sa i përket investimeve kapitale, na kemi investue dhe janë t'u investue nëpër bjeshkë, qysh kanë fillue qato investime në qeverinë paraprake, disa rrugë të bjeshkës kemi fillue t'i vazhdojmë dhe t'i rregullojmë, e ndoshta diku edhe të hapim rrugë të tjera. Unë besoj se gati ni pjesë bukur e madhe e fshatrave kanë qasje mo blektorët me mjete transportuese nëpër bjeshkë, në shmuicën e bjeshkëve tona dhe kjo është ni lehtësim për ata blektorë që merren me bujqësi. Sa i përket bujqësië, të tregova, në bujqësi investime na shtalla s'mundim me ndërtoe, janë grantet qeveritare ato që i rregullojnë dhe qeveria është t'o dhonë mjaft. Ka çështje që ndonjëherë iu bëhet e padrejtë fermerëve tanë në ndarjen e granteve, atë s'mund ta vërtetoj, mirëpo kanë fillue që brenda këtij viti dy shtalla janë t'u rregullue, me sa e di unë, dhe janë disa investime kapitale. Sa i përket subvencioneve, mjetet janë të limitume, vjet kemi nda ni pjesë të mjeteve, subvencione direkte edhe si komunë për bujqësi, mirëpo këtë vit i kemi punët pak ma ndryshe. Artan Loshaj, si do të investohet nëpër prona private. M'u dok se e sqarova pak ma herët, përmes atyre marrëveshjeve që do të bëhen te noteri. Besoj se do të mundohemi që ta kalojmë. Po prej qasaj dite kur i ka hup zgjedhjet mo është i shfuqizuar ai kryetari i juaj. Kërkoj falje, se pak e pata me bo humor! Sa i përket rrugës së stadiumit, na kemi marrë ni pëlqim prej Ministrisë së Pylltarisë, edhe kur e kemi hap edhe tash e kemi marrë, besoj se edhe ai problem do të zgjidhet. Nashta nuk na çon në burg kërkush për ni rrugë të stadionit që po ia bojmë. Driton Ademi, kubëzim-kanalizim, çka doni me bo me 50 mijë euro. Driton, me 50 mijë eurot e kemi parapa bre burrë, kur të ndërtohet, ju e keni nis atë projektin e asaj sallës, ajo kur të ndërtohet duhet me i pas edhe pajisjet. Në qoftë se bëhet si sallë edhe pa pajisje jetë si e vdekur. A po thuesh me e lonë qashtu ti, a qysh e kie mendjen? Po jo more, se është lidhë kontrata, janë t'u krye punimet, kur të vjen veç e kemi poshtë me i shti pajisjet. 90 mijë, kanë me shkue edhe 100 mijë, na s'mundim me kundërshtue atë, se OSHP-ja na ka pru mas përfundimit të Vitit të Ri përgjigjen more, të lutem, na ka shti në obligime, nuk e kemi lonë punën zhag, jemi t'o çue shumë mirë, mos u tut, ka me u bo ajo salla aty. Qetu edhe ti ke pyet për stadionin e fshatit Blaç. Ta sqarojmë ni herë mirë këtë stadionin e fshatit Blaç. Stadioni i fshatit Blaç ka ardhë me ni tension nga komuniteti edhe nga klubi, thuesh se për dy ditë mund të bëhet ni stadion. Ju e dini që për tre muaj ditë kemi nga për me e gjet ni herë lokacionin, për shkak se KF 'Opoja' është t'u krijue shpenzime të cilat po duhet me ia mbulue, edhe ia kemi mbulue, edhe qeveria paraprake edhe qeveria jonë. Na pa desht me hi në komentime çka ka ndodhë me stadionet, çka ka ndodhë me investimet, kemi fillue aktivitetin edhe e kemi caktue qat lokacion, meqenëse s'kemi mund të marrim leje, e kemi bo si rindërtim të stadionit ekzistues. Blaçi ka shprehë interesimin se kemi donatorë. Këtu janë tre partnerë; Komuna, donatori dhe FFK. Kemi marrëveshjen për këtë projekt. Projekti është nënshkrue vjet dhe vjet edhe sivjet kryhet pjesa e Komunës, paret të cilat i ka nda Komuna për atë stadion, dhe Komuna e kryen pjesën e vet. Mbesin dy akterët tjerë, vijnë masi të kryhet kjo, dhashtë Zoti brenda dy-tri ditëve fillojnë punimet. Për shkak të reshurave atmosferike nuk ka mund të hyhet në ata stadion m'u punue. U nalë shiu, është Bajrami, do të fillojë kismet prej Zotit, të hënë vjen po s'deshtëm me precizue ditë, se na s'un e shtyjme me Zotin, na kemi mendue ma herët me nis, po s'kemi mund me bo se shiu, ka mund me fillue ma herët. Ajo puna është e kontraktume stadioni vjet, edhe thuhet është prish, pa u prish nuk ndërtohet. Po mirë, qe blaçasve po ju them se ai stadioni pa u prish nuk ndërtohet. Qytetarët e fshatit Blaç shumë mirë më kuptojnë, hiç pa u thonë unë e dinë qysh është gjendja praktike, se jemi t'u krye punë qysh është ma mirë e mundshme. Nuk ka nevojë hiç me iu kallxue, se ata janë përditë aty, s'kam unë çka komunikoj me blaças, po është për apetitet e juaja politike. Edhe kompania do ta kryjë atë punë. Agron Gashi, sa i përket fshatit Brezne. Agron, o i nderum, dy herë, herën e parë nuk ta tërhoqa vërejtjen, sot, është mirë me folë fjalë të mira, po duhet pak pragmatikë m'u konë. Në qoftë se hyjmë ashtu në lokalizma, na mendojmë se në fshatin Brezne shumë ma shumë kemi bo. Kemi gjet projekte në fshatin Bresanë, që s'kemi mund me i guajt na ato pare dhe kemi luftue me i mbrojt. Janë tri pojekte trevjeçare, është i Kukit trevjeçar. A na kanë kushtue, na kanë kushtue, a i vërvesim, nuk i vërvesim. Tash pse s'po bëhen në Kosavë, po më vjen inat, po me inat këto punë nuk bëhen, shteti edhe shpia s'mbahen me inate, o shoq. Janë gjëra konkrete, i kemi bo edhe këndet e lojrave nëpër fshat, krahasimet të cilat po i bojsh, në situatën në të cilën jemi nuk e kanë vlerën. Unë pajtohem me krahasimin tënd, po në ni rrethanë edhe situatë tjetër. Na edhe në qato fshatrat ku kemi nxënë edhe fëmijë,

si mos të investojmë me kohë, na mund t'i bëjmë krejt stadione, krejt fshatrave statione, s'kemi fëmijë more për stadione. Andaj të jemi korrekt, mos të fillojmë me këso lokalizma, se këta lokalizma nuk na çojnë kërkund dhe jemi t'u mundue realisht, pa u mundue askënd me ofendue... jo more s'kam nevojë me të thonë, unë po foli për principet e mia...

Uran Halimi: Po më vjen keq që po duhet me të ndërpre, drejtor, po është e ulët me ia tërhek vërejtjen ju nga ekzekutivi delegatëve. Me i thonë po ta tërhek vërejtjen, s'po më pëlqen...

Qamil Kolloni: Kryetar i nderum, dëgjo këtu! Në qoftë se flasim për ndryshimin e filozofisë së investimit të buxhetit dhe zhvillimit ekonomik, janë këto strategji të cilat ndikojnë. Në qoftë se duash të ndryshosh filozofinë e zhvillimit ekonomik, këtë duhet ta dish si parim, duhet të ndryshosh edhe logjikën e të menduarit. Në qoftë se mendosh me lokalizëm dhe kërkosh zhvillim ekonomik, je gabim.

Uran Halimi: Jo, unë fola për filozofinë e sjelljes kundrejt delegatit.

Qamil Kolloni: Jo, po kjo të tregon ty, është mënyra për edukim se si ndryshin filozofia për zhvillim ekonomik. Ti në qoftë se këtë s'e kupton kështu, atëherë nuk e di cilat janë konceptet e ndryshimit të mentalitetit në ekonomi. Veç pak, t'i përfundoj edhe këtë. Sa i përket Qendra për Mjekësi Familjare, drejtori i Shëndetësisë ju jep përgjigje. Sa i përket këshillave të fshatrave, unë mendoj se për stadiumin s'kam çka flas, dhashë përgjigje për stadiumin, për QKMF-në le të të japë drejtori edhe drejtori i Administratës. Kurse sa i përket derdhjes së kanalizimeve nëpër lumenj, kjo është gjendja, këto 7 mijë eurot janë pa për me e sanue problemin në Zgatar, do të kqyrim edhe metodën e funksionalizimit të asaj gropës septike atje që është ndërtue. Edhe këshillat e fshatrave besoj që tash e tutje do të fillojmë edhe me këshillat e fshatrave, të bëjmë dëgjimet publike nëpër fshatra, që të mundim këto mjete të cilat i kemi nda, t'i emërojmë edhe projektet, edhe të fillojmë që në shtator ta bina të detajuar edhe buxhetin për investime kapitale. Faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit, drejtor! Ni replikë të vogël edhe mandej kemi kohë edhe këta të cilëve ua ke përmend emrat me e marrë fjalën edhe me bo replikë. Unë te stadioni veç thashë mos t'i hupim ata donatorët, se shumë joserioz jemi t'u kallxue. Ishalla vazhdojnë punimet edhe bohet shumë mirë, unë uroj punën e mirë në atë stadion. Sa i përket vërejtjeve që po ia tërhekish delegatit, vetëm e thashë, është mirë me na respektue, se na mundim mos me ju dhënë fjalën hiç. Kështu që sillnu mirë, unë jam për me i mbrojt delegatët, pa dallim partie politike, është mirë me u sjellë mirë, sidomos ekzekutivi në raport me ne. Se ju pa ne, e dini shumë mirë që s'mundni me funksionue. Nëse ia nisni me ofendue edhe me nxit, është e ulët kjo. Këtu jemi në seancë edhe delegati veç ka të drejtë me folë. Vërejtjen s'mundish me ia tërhek. S'ka lidhje, vërejtjen s'mundish me ia tërhek, veç sqarim mundish me dhonë. Sido që të jetë, çka janë 7 mijë euro për kanalizim, 7 mijë euro juve foto s'ju dalin me bo, e projekte, mos boni hajgare. Sinqerisht po të thom, 7 mijë euro qe ku e keni këtu ni buxhet goxha hajgare, asfaltimi i rrugës Brrut-Zgatar edhe rregullimi i rrugëve të asfaltuara Kuk-Kosavë-Pllajnik-Kapre-Brrut-Brezne-Buqe-Pllavë-Rrenc-Shajne, 7 mijë e 900 euro. Nejse, okej, janë parapa, paushall s'bohen bre 7 mijë euro 200 projekte me 7 mijë euro, vallahë foto s'ju dalin, bateri të telefonit 7 mijë euro. Sidoqoftë, është koha e replikave. Më fal, edhe dy drejtorja i kemi që po dojnë me raportue, Vetimi edhe kush tjetër? E kemi edhe drejtorin e Shëndetësisë që e thirrëm, ia bona ni pyetje unë në lidhje me buxhetin e ndarë për shëndetësi. Si të je konë këtu drejtor, a je konë këtu? Po. Atëherë e ftoj drejtorin e Shëndetësisë me e marrë fjalën.

Behar Brenoli: Selam alejkum, ju urojme te gjithëve gezuar Bajramin. Nëse i referoheni pyetjes që keni bërë më parë për barnat esenciale dhe planifikimin e buxhetit, mendoj se kemi folur disa herë që përgjegjësia për barnat esenciale është drejtpërdrejt me ministrinë. Qendra e mjekësisë familjare në Dragash i siguron ilaçet esenciale nga ministria. Është Ministria ajo që ofron barnat esenciale. Faleminderit. Fondet për mallra dhe shërbime, këto mjete nuk janë investime kapitale. Dhe se këto mjete do të përdoren për mallra dhe shërbime.

Uran Halimi: Veç pak, drejtor! Unë të pyeta ku janë planifikue me shkue qato pare që janë planifikue me shkue për shëndetësi? Ku do të shkojnë ato? E kemi këtu buxhetin që është paraparë për shëndetësi. Nuk e di a e ke pa. A mundish me m'kallxue për çka, ku është dedikue, ku ka me shkue. I kie 175 mijë euro, ku janë planifikue me shkue ato, ku do të investoni?

Behar Brenoli: Buxheti për mallra dhe shërbime. Këto nuk janë investime kapitale, këto janë mallra dhe shërbime. Faleminderit!

Uran Halimi: E mora përgjigjen. Sidoqoftë, drejtor s'më ke thonë kurgjo, po mirë që e ke marrë fjalën.

Mundish me dalë ti, kryje edhe ti drejtor, edhe ka ni minutë replikë e bojme, nëse do dikush me e përmbyllë prej ekzekutivit, munden, edhe mo e kryjmë.

Vetim Ramadani: Përhëndetje të gjithëve! Shfrytëzoj rastin edhe një herë t'ua uroj të gjithëve festën e Kurban Bajramit! Nëse nuk gaboj, kryesuesi m'u drejtue me ni pyetje në lidhje me administratën, buxhet shumë a lloptopat e asambleistëve nuk janë. Realisht më datën 21 qershor të këtij viti, që i bjen ni javë më herët, 8 ditë saktësisht, është nënshkruar veç kontrata për pajisje me lloptopë për të gjithë asambleistët, pra për 27 lloptopë edhe afati i liferimit është 60 ditë. Do të thotë, sipas kontratës, deri më 19 gusht 2023 lloptopat duhet të sillen në komunë. Performancat nuk i përcaktojmë ne, i përcakton AQP-ja, mirëpo nga ana jonë është përzgjedhur modeli ma i miri që ekziston, do të thotë është modeli i parë i lloptopit. Mbi këtë standard ne nuk mund të kalojmë, sepse kjo është e kontraktume, do të thotë janë dy modele të lloptopëve dhe tre modele të PC-ve, të kompjuterëve. Lloptopi për asambleistë është lloptopi ma i mirë, është modeli i parë edhe ma i kushtueshëm, natyrisht. Sa i përket buxhetit, ky buxhet është, edhe shërbimet që i kryen Administrata, realisht duhet me e ditë që Administrata kryen shërbime për të gjithë drejtoritë. Edhe për këtë arsye shpjegohet edhe kjo lartësia e alokimit të mjeteve në Drejtori të Administratës. Faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit, drejtor! Në rregull, është koha për replika, po fjalën e ka kërkue z.Samidin Xhelaidni. Replika kanë kërkue këta, nëse kie diçka me i pyet drejtorat në lidhje me këtë pikën, mundish!

Samidin Xheladini: Të nderuar të pranishëm, ju përhëndes të gjithëve dhe ju uroj festën e Kurban Bajramit, juve dhe të gjithë qytetarëve të komunës sonë! Unë mendoj se Qeveria Komunale duhet të bëjë angazhimin maksimal dhe duhet të reflektojë në të gjitha projektet dhe propozimet që janë të nevojshme dhe prioritete kyçe. U propozuan këtu nga diskutimi publik dhe delegatët, si dhe faktorë të tjerë relevantë të cilët duhet të ofrojnë propozimet konkrete. Unë mendoj se vetëkënaqësia nuk duhet as të mendohet, lokalizmi kurrsesi, angazhimi i të gjithëve duhet të jetë maksimal, për shkak se është interesi i të gjithë qytetarëve. Deshta – këtu sot pak vërejta një gjë jo të këndshme – në diskutimin publik nuk kanë ardhë delegatë në numër të mjaftueshëm. Diskutimi publik është për qytetarë. Ne si delegatë edhe zyrtarët duhet të vijmë, të marrim pjesë dhe të dëgjojmë. Sot është dita jonë, na duhet të japim kontributin tonë dhe të angazhohemi të gjithë, na delegatët e kemi sot ditën, jo në diskutim publik edhe duhet kjo të dihet, që në diskutim publik ua marrim të drejtën qytetarëve, jo që s'kemi të drejtë me diskutue. Po mos po ua marrim të drejtën, në qoftë se nuk jemi përfaqësues të fshatrave. Na kemi të drejtë me dhënë sot propozime dhe, po më vjen keq po duhet me e përmend që asnjë femër nuk diskutoi deri më tash. A në diskutim publik atë ditë, thuajse 40% kanë diskutue femra. Sot është dita me u angazhue që delegatët që janë prezente këtu, me dhonë propozimet, se këtu është ma me vlerë se në diskutim publik, se në diskutim publik marrin edhe tjerë pjesë edhe s' duhet me ia marrë hisen që iu takon. Ju faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit shumë! Po vazhdojmë me replikat. Fjalën e pat Shpetim Hajredini nga PDK, pas tij fjalën e ka Nedžmidin Sejdar, pas Nedžmidinit fjalën e ka Agron Gashi edhe vazhdojmë më tej.

Shpetim Hajredini: Atëherë përhëndetje edhe ni herë për të gjithë! I nderuar drejtor i Financave, faleminderit për përgjigjen! Patjetër që është dashtë që të dalë edhe një herë ta marr fjalën dhe të diskutoj për përgjigjet të cilat i dha për pyetjet të cilat i parashtrova më herët. Përmende projektin e asfaltimit trevjeçar të fshatit Kuk. Dy projekte, s'di pse thajë afekton shumë në buxhet, po 180 mijë po më duket janë krejt-krejt, të dy projektet nëse nuk gaboj. Edhe ky viti është vit përfundimtar, nuk besoj që ka ndikue tepër, saqë fshatrave tjerë me iu marrë edhe më iu nda më pak shpenzim. Besoj që është vetëm një arsyetim që në fshatin Kuk po punohet diçka, ky është projekt tash trevjeçar, vitin e parë ka ndodhë si ka ndodhë, se përndryshe ky projekt do të kishte përfundue tani, nuk do të ishte diskutuar fare më tutje. Por ajo që e pashë unë në 2024-tën, në bazë të planifikimit e pashë që është zvogëlue buxheti. Unë këtë s'deshta me e diskutue fare për fshatin Kuk, se nuk është Resuli këtu prezent, po të kishte qenë Resuli, unë me të kisha diskutue, edhe nuk po hi fare, nuk po diskutoj, po e lë për shtator. E kemi preznet këtë, është edhe kryetari dhe me atë diskutosh, tek e fundit, ti nuk je përgjegjës për projektet e fshatit Kuk, ato kanë ardhë nga persona që janë për momentin përgjegjës të fshatit. Tjetra, rrugicat private, unë e bona ni pyetje direkte, vetëm thashë është e ligjshme apo nuk është e ligjshme. Vetëm ke mund me më thënë po ose jo. Edhe unë jam për më ua përfundue edhe atyre që iu kanë mbet, mirëpo vetëm ta bëra pyetjen, është e ligjshme apo jo. U solle përreth, nuk ma dhaje përgjigjen, po okej, e kuptova esencën e fjalimit. Tjetra, shpenzimin e ndriçimit publik nuk ma dhaje përgjigjen, m'i ike edhe kësaj prapë, po duhet me ma dhënë përgjigjen nëse kie njohuri. E dhaje për shërbimet publike, rritja e buxhetit, mirëpo nuk ma

dhaje përgjigjen, po, e kuptova edhe unë atë, po unë po të them që nuk duhet me më anashkalue kur ta bëj pyetjen, ma jep direkt. Përndryshe, unë e kuptova, thaje është për diçka tjetër, për kanalizim ose diçka që del urgjente, kjo rritje e buxhetit të shërbimet publike. Do të thotë shpenzimet e ndriçimit le t'i harrojnë qytetarët edhe për këtë vit, le t'i ndajnë prej xhepit të vet edhe le ta kryjnë pagesën. Pasi që nuk është kryetari, po pres në shtator e kemi, ishalla jemi gjallë e shnoh, unë kërkoj prej tij tash deri në shtator detyrimisht të futet edhe shpenzimi i ndriçimit publik. Investimet kapitale bujqësore, nuk e pata fjalën për subvencionime direkte, se atë e kuptoj, e di. E pata fjalën që, unë jam i bindur që ti i ndjek edhe format se si i përdorin qytetet tjera për ta ndihmuar bujqësinë dhe blegtorinë, do të thotë përmes Zyrës së Prokurimit. Shembull konkret e ke tash Prizreni vetëm e kishin hap projektin, edhe me bashkëpunim financimi me fermerët. 15% po e merrshin prej fermerit, pjesën tjetër të shpenzimit po e ndajnë vetë komuna. Ju kisha preferue edhe juve që ta merrni këtë shabllon, ta përdorni në këtë formë, ose në forma tjera, po të ndikojmë direkt, ju lutem që të ndikojmë direkt, t'iu lehtësojmë sadopak punët e tyre dhe të qendrojnë edhe pak, bile edhe disa vite në këtë trevë, përndryshe ata na u larguen dhe, ju kam thënë edhe ni herë e po ju them prapë, pas dy viteve, se tash na mbeten edhe dy vite të jemi këtu, pas dy viteve nuk kemi as prej kujt kemi me kërkue votë. Ikën të gjithë. Tjetra, projekti i ujit thaje që është projekti prej 2013-tës apo i ekzekutivit të kaluar. Ky projekt ka shkue në pikën zero, drejtor, ti e dish. Keni mund ju me e ndryshue, pse po e lejoni, o me e fut edhe Buzezin, o edhe çka ka pas ndonjë fshat tjetër, apo ta revidoni komplet, ta ndryshoni komplet, se kjo ka shkue në pikën zero. Ne s'kemi mund, përmes bllokimit të OSHP-së, shumë vite kemi nda, kemi shkue në suficit, kemi pas dëshirë ta realizojmë, nuk na kanë lejuue dhe erdhëm ku erdhëm, deshti fati, në këtë moment keni mundësinë ta realizoni, realizoni në mënyrën ma të mirë të mundshme, gjeni opsionet, futne edhe fshatin Buzez, se una jam i bindur që edhe ju e pranoni kërkesën e Sefidinit. Nexha tha se ne si grup do ta mbështesim, po edhe ju jam i bindur që e mbështetni. Kështu që le të futet edhe fshati Buzez, në bazë të mundësive buxhetore. Unë e di, e kuptoj që nëse nuk keni mundësi buxhetore, nuk mund të realizohet, mirëpo së paku deri në fund të këtij mandati mund ta realizoni dhe fshati Buzez të jetë i kyçur në këtë projekt të Ujësjellësit. Prandaj nuk po e zgjati, pata me diskutue dhe për stadionin edhe për projektet e tjera, po kryetari s'po më lejon ma shumë se kaq, po e lëmë në pikën tjetër, në pikën eventuale. Ju faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit, z.Hajredini! unë deshta me e lyp mirëkuptimin e juaj, që me e krye këtë pikë të rendit të ditës, me i përshpejtue ato replikat. Po e shoh që kanë me u zgjat e me u stërzgjat. Po shkojmë në pauzë deri në ora 13:00 edhe kthehemi.

Po vazhdojmë. Fjalën e ka z.Sejdilar, pas tij z.Jetmir Ajdini edhe po vazhdojmë ma tutje, nëse dikush e kërkon fjalën më lajmëroni, ju lutem!

Nedžmidin Sejdilar: Pershendetje te gjithëve pres përgjigje te sakta nga z.Drejtor. Ju pyeta për ujësjellësin për t'u sqaruar më mirë dhe më me detaje se projektin e keni trashëguar nga viti 2012. Që atëherë kanë kaluar 11 vjet. Dhe mendoj se më së miri do të ishte që fillimisht të bëhej një lloj rishikimi, sepse nga viti 2012 e deri më tani qytetarët kanë kërkuar një rrugëdalje për furnizimin me ujë të pijshëm. Jo të gjithë i kanë pritur këto 11 vite pa ujë të pijshëm. Sipas informacioneve që kam, nga lista e fshatrave që janë përfshirë në këtë projekt, ka fshatra që e kanë zgjidhur përfundimisht atë problem. Dhe tani ata nuk duan të jenë pjesë e rrjetit qendror të ujit. Si do ta zgjidhni me qytetarët dhe a keni ndërmend të bëni sërish debate publike me qytetarët, për të dëgjuar sugjerimet, kritikën, pakënaqësitë e tyre. Në këto 11 vite në Gorë është shpërngulur 40% e popullsisë, ndaj edhe tubat e vjetër të ujit tashmë janë të mjaftueshëm. Nuk ka nevojë për investime të panevojshme dhe aq më pak për detyrimin e qytetarëve për të paguar ujin që tashmë kanë, krahas të gjitha shpenzimeve që kanë çdo ditë. Sa i përket parkut në Dragash, ju thatë se për pak vota keni udhëhequr politikën, por nuk më keni thënë në thelb se si do të ishte ai park. Këtu jepen mjete prej 40 mijë euro, hapësira ku planifikoni ta ndërtoni atë park është shumë e vogël për 40 mijë euro. A po ndërtohet një park për fëmijë, po ndërtohet një parking dhe a do të na e jepni atë projekt. Ti z.Kolloni në atë rast zoti drejtor, nëse në bazë të gjeoportalit, edhe unë duhet ta heq krevatin nga dhoma e gjumit dhe ta vendos në oborr, sepse sipas gjeoportalit, linja kalon nga mesi i shtëpisë sime. Dua të tërheq vëmendjen tuaj për çështjen e gjeoportalit sepse të dhënat janë të pasakta. Ndodh shpesh që banorët të grinden dhe të zihen për shkak të atij gjeoportali. Kjo do të ishte një pyetje shtesë për drejtorin e kadastrës se si do ta zgjidhë. Biseduam për Stadiumin në fshatin Bljaç. Ju dhe unë patëm një diskutim shumë të nxehtë për atë stadium, pas kësaj ju dhashë mbështetje për të ndërtuar atë stadium. Asnjëherë nuk jam kundër dhe as

nuk mendoj se dikush nga ne është kundër investimeve dhe ndërtimit. Por kur na erdhi një peticion këtu, një kërkesë nga klubi i futbollit Opolje, i cili ka rezultate të jashtëzakonshme, morëm që stadiumi duhet të ndërtohet urgjentisht, me urgjencë, sepse ata lojtarë të mrekullueshëm të komunës sonë që na sjellin tituj nuk kanë ku të stërviten. Ne ju kemi dhënë ju zoti drejtor pëlqimin dhe mbështetjen që ai stadium të ndërtohet sa më shpejt. Nuk ka urgjencë nëse ai stadium ndërtohet për dy, tre, katër vjet. Problemi nuk është ndërtimi i stadiumit, problemi është pse nuk ka përfunduar. Ju personalisht keni premtuar për këtë platformë se do ta zgjidhni atë stadium sa më shpejt. Koha më e fundit ose urgjenca kuptohet të jetë 3.6 ose maksimumi një vit. Por shtyrja e projektit për dy ose tre vjet nuk është më një çështje urgjente. Ju kërkoj të dilni, nëse nuk ju pengon, këtu në këtë tribunë dhe të na tregoni afatin se kur do të mund të luajmë në atë stadium. Ju kujtoj sërish të më shpjegoni se cili është projekti i parkut, jam jashtëzakonisht i interesuar për të. Besoni se ka indikacione se do të krijohet problem mes popullatës në Dragash lidhur me këtë park. Në emër të të gjithë qytetarëve, nga një peticion dhe nga tjetri, që ju si qeveri e organizuat vetë për të mbuluar të parin, na tregoni dhe përshkruani se çfarë do të ndërtohet aty. A do të jetë thjesht një zonë e gjelbër me pajisje ku do të luajnë fëmijët? A do të ketë parking apo diçka tjetër? Për sa i përket ujësjellësit qendror, ky ujësjellës merr fonde nga të gjitha fshatrat dhe një shumë të konsiderueshme parash. Nëse po ndërtohet ujësjellësi qendror dhe nëse përfshihet p.sh. fshati Mlike, pse e paguajnë qytetarët e fshatit Restelicë? Ju thatë pak më parë se këtu buxheti është i ndarë për kokë banori, nëse po pse po shkon në dëm të qytetarëve të fshatit Restelicë ndërtimi i ujësjellësit qendror, i cili përsëri them se duhet rishikuar. Në mënyrë që fshatrat që kanë zgjidhur problemin e ujit të pijshëm të mos përfshihen në këtë projekt. Rruga që nisi me asfaltim, Zlipotok-Backë-Brod, aty nuk prisje asgjë. Kur mendoni ta bëni gati atë rrugë, sepse nëse ajo rrugë merr një dimër tjetër, ne do të duhet ta bëjmë përsëri. Është humbje parash. Dhe ky është një nga projektet që keni trashëguar, siç e thatë pak më parë. Pse e ndaluat atë projekt të trashëguar dhe kur do të shtrohet ajo rrugë. Mendoj se meritoj përgjigje për këto pyetje. Dhe ju, zoti Drejtor, si politikan me përvojë, ju lutemi të na jepni përgjigje praktike për pyetjet e ngritura.

Uran Halimi: Faleminderit, z.Sejdilar! Mirë është mos me e zgjat qaq shumë, se i kemi replikat, po vazhdo Jetmir.

Jetmir Ajdini: Përshëndetje dhe ni herë! Deshta me u ndërlidhë te projekti i stadionit të fshatit Blaç. Në seancën që kemi diskutue për stadionin, kur janë nda 50 mijë euro për fillimin e punimeve, e dimë arsyen pse ka ndodhë ajo, për shkak të problemeve që ka pas me rrugën stadionin i qytetit në Dragash, i është ndërrue lokacioni dhe është gjet si lokacion fshati Blaç. Janë nda 50 mijë euro në atë seancë, në atë seancë i kam thonë ekzekutivit që me 50 mijë euro nuk ndreqet stadion. Kanë fillu punimet, kanë mbet në gjys, janë stërzgjat edhe nuk e dimë kur fillojnë edhe kur përfundojnë. Në atë seancë i kam tregue Klubit të Opojës që keni me vazhdue me i mbajt stërvitjet nëpër stadione tjera, në Prizren edhe ku e di unë ku. Domethënë është shumë e saktë ajo që klubi jonë vazhdon i mban stërvitjet në Prizren edhe s'e di ku tjetër vazhdon me stërvitje. Tash kanë fillue punimet për stadionin e qytetit në Dragash, ku është nda ni shumë e mjeteve, është hap rruga, është gjet ni zgjidhje që ma në fund të fillojnë punimet edhe stadiumi i qytetit të ndërtohet në qytet, në Dragash. Tash i kemi dy projekte, e kemi projektin e stadionit në fshatin Blaç, që është projekt i stadionit të qytetit, nuk është stadion i fshatit Blaç, ai është stadion i qytetit të Dragashit, edhe e kemi projektin e dytë që ka fillue për stadion në Dragash. Tash është pyetja jeme, cili ka m'u konë stadionin i qytetit? A stadionin i qytetit ka m'u konë në Blaç, apo stadionin i qytetit ka m'u konë në Dragash? Qyteza, ni ndër qytezat ma të vogla në Kosovë, që ka me i pas dy stadione të qytetit. Me dal me na dhonë dikush përgjigje prej ekzekutivit, me na tregue cili ka m'u konë stadionin i qytetit Dragash. Faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit, z.Ajdini! Fjalën e ka kërkuë z.Gashi.

Agron Gashi: Atëherë, më lejoni të ju përshëndes edhe ni herë, të pranishëm delegatë! Unë po filloj nga kryetari, i cili...ky ekzekutiv dhe kryetari më vjen mirë që vitin paraprak i takoi qytetaert dhe ishte në fshat, thujse në pjesën dërmuese të fshatrave, takim me qytetarë për t'i marrur preokupimet e tyre, kërkesat e tyre. Dhe në këtë kuptim pra, tash kanë gjetur zbatim praktik që kërkesat e tyre janë kthyer në investime kapitale për vitin 2023. Në këtë drejtim nuk kemi shumë dilema, por gjithashtu edhe është vlerësuar pozitivisht nga Instituti i performancës, ku e ka nxjerrë për një pozitë më të mirë për dhjetë vende, dhe nga kjo nuk kemi shumë shqetësime. Por ajo që desha të them është që në fakt në fshatin e Bresanës desha një përlllogaritje, që për dhjetë vitet e fundit apo prej pasluftës, po sikut t'i nxjerrësh statistikën, keni një përqindje shumë më të madhe të

investimeve në krahasim me fshatrat tjerë. Dhe është kthyer dinjiteti, të thuash kuptimisht, janë kthyer investimet në fshatin nga vij unë, se unë jam banor i atij vendi, jam prezent dhe shkoj i shoh punimet për çdo ditë, se është bo ndriçimi i fshatit, është duke u çelur rruga shekullore e cila nuk është prekur fare, quhet 'Rruga e Shullonit' dhe është bo ni trasim, ni rrugë e gjerë dhe është intervenuar falë këtij ekzekutivi. Po gjithashtu edhe kanë filluar punimet e Ujësjesit, që është ni projekt për 16 fshatra, veç se makineria është duke u parë duke punuar atje, por njëkohësisht tashti edhe ka qenë në Komunë, në Zyrën e Prokurimit, tenderi i hapur për kanalizimin e fshatit Brezne, sepse fshati Brezne ka 120 mijë euro investime në këtë vit për kanalizim. Por tani kuptova nga një personel i juve këtu, të një drejtori këtu, se paska dështuar, nuk ka fitues, shkon në ritenderim edhe ni herë. Unë ju kisha lutur që mos të zvarritet koha shumë, sepse jemi në një trevë ku kemi ni klimë të ftohtë, dhe mos të ikin muaj pas muaji dhe tani me keqardhje dështoi, sepse janë bukur një shumë e konsiderueshme dhe qytetarët e mirëpresin, nga të gjitha investimet që bëhen atje, këtë punim të kanalizimit e mirëpresin dhe duhet që të jeni pak më kompetentë dhe t'i gjeni kompanitë fituese dhe të fillojnë punimet atje sa më parë. Kjo ishte e tëra që deshta të flas, por gjithashtu edhe z.Hajredini që foli pak më herët, tha për bujqësi e blegtori, unë pajtohem plotësisht që këtij sektori duhet t'i jepet përkrahje. Por gjithashtu edhe drejtori shumë qartë tha se disa gjëra janë prej nivelit qendror, që subvencionet gjithashtu në blegtori, unë e di se për kokë dele jepen 25 euro, për lopë gjithashtu, por edhe për të mbjellurat jepen në hektarë. Dhe kështu që janë disa limite, por e tha drejtori se do të rregullojmë vetëm infrastrukturën që të kenë bujqit dhe blegtorët një mundësi për të ushtruar veprimtarinë e tyre. Faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit shumë, z.Gashi! Ni minutë replikë z.Driton Ademi nga PDK.

Driton Ademi: Faleminderit, kryesues! Nja dy pyetje për drejtorin, nëse ka mundësi me i ditë. Në shumicën e fshatrave ka fillue ndriçimi publik. Qetash, a ka naj mënyrë për pagesën e tyre, për pagesa edhe për mirëmbajtjen e ndriçimit? Edhe ni pyetje tjetër është për caktimin e...domethënë që po bëhen investimet kapitale nëpër fshatra, nuk po e dinë njerëzit ku ka m'u investue, s'është me rëndësi shuma. A do të ia vini emërtimin e rrugicave, ku kanë me u investue ato punime. Edhe ni përgjigje e kisha desht prej kryetarit, po masi s'është, është në Haxh, ishalla Allahu ia ka bo kabull, po vjet nuk ka mbajt dëgjim publik, i vetmi fshat që është Bresana që nuk ka mbajt dëgjim publik. Kështu që, kisha pas qef, masi s'është ai, prej jush ni përgjigje, ose kur të vjen kryetari vetë përgjigjet.

Uran Halimi: Faleminderit, z.Ademi! Unë po besoj që ja në Bresanë bëhen debate publike, se ai i Bresanës është edhe e nalin qytetarët në rrugë. Ma interesant më erdhe me dëgjimin publik që ka ndodhë këtu në komunën tonë. Na, ni trajnim që e kem bo, kanë thënë që dëgjimin publik duhet me organizue asambleistët bashkë me ekzekutivin. Nëse e mbani mend, vjet u konë ky trajnimi. Edhe dëgjimi publik që kish ndodhë ish konë shumë i frytshëm, po krejt me skenar. I përgatitur ma së miri, që tha edhe Samidini që vajzat kanë folë shumë aty, e qetash pse s'po folni, po s'e kanë skenarin qetash. Sidoqoftë, në debat publik kanë marrë pjesë jo qytetarët, po nëpunës të Komunës shumica janë konë. Edhe m'u konë mbledhje e kryesisë, ma së shumti, të partisë. Sidoqoftë, po vazhdojmë me e hedhë në votim pikën e dytë edhe shumë të diskutueshme të rendit të ditës. A, përgjigjet nime ti, drejtor.

Qamil Kolloni: Unë kënaqem ndonjëherë Shpeta kur më bon pyetje, se më bon pyetje që janë të natyrës teme edhe shumë ma lehtë e kam me iu dhënë përgjigje, edhe gjej në njëfarë forme edhe gjuhë të përbashkët. Sa i përket investimeve kapitale në bujqësi përmes shoqatave, Shpeto, kemi bo angazhime, çue disa kërkesa, disa shteteve, edhe nëpër ambasada, që të iu ndihmohet këtyre, për arsye se, e dish ti, ngjarjet e fundit të cilat kanë ndodhë, një numër i shoqatave të ndryshme ndërkombëtare janë orientue me investime të ndryshme, tash mos të mbajmë politikë të nivelit të naltë. Po kemi vështirësi me kontaktue me ish-organizatat joqeveritare që kanë veprue në komunën tonë edhe kanë qenë ekskluzivisht, drejtpërdrejt të interesuara për zhvillimin e bujqëisë edhe blegtorisë. Prandaj kemi kontaktue edhe me do shoqata, po tash me bo publike deri sa s'kemi rezultat edhe s'kemi përgjigje, po na del pak i e tepërt. Ju e dini se, në uebfaqen e komunës na edhe ato kërkesa që i kemi çue nëpër ministri edhe nëpër shoqata, janë edhe nuk po dona me i bo publike, po shpresojmë se mund të gjojmë, se me bashkëfinancim, iu kemi ofrue edhe disa shoqatave që edhe me bashkëfinancim me mund me iu ndihmue bujqve dhe e kemi këtë çështje. Sa i përket Buzezit, nuk kemi desht ta bëjmë para kohe publike, kemi bisedue edhe për atë çështje, është çështje e inxhinierave, derisa nuk mundim me thonë që po e bëjmë atë. Pjesë e këtij projekti që e kemi gjet, deri më tash s'kemi mund me e gjet mënyrën dhe përgjigjen adekuate, jemi në

bisedime e sipër. Projekti ka me zgjat dy vite, në qoftë se bazamenti bëhet mirë deri atje edhe teknikisht ka mundësi me u ekzekutue, pse jo edhe Buzezi mos m'u konë pjesë e këtij projekti. Nexho, për ujin, në vitin 2012-13, nuk e kemi bo revidimin, qe ky është qaj projekti, qeto fshatra janë që marrin pjesë. Ky uji shkon deri në bazen, në qoftë se nuk janë të interesuet fshatrat me e marrë, nuk e marrin. Ky nuk jau zgjidh krejt fshatrave përfundimisht problemin e ujit, e zbut problemin e ujit në disa fshatra, po me rëndësi është, 15 fshatra pak a shumë e zbutin problemin e ujit. Nuk është ky fundi i botës edhe do të jetë investimi i fundit në ujë edhe mo nuk ka nevojë Komuna e Dragashit për investime tjera për ujë ose në fshatra tjera. Nuk ka kurrfarë problemi që janë bo edhe disa investime të tjera nëpër fshatra, të cilat janë pjesë e projektit, se kanë bo investime në rrjetëzim, kanë bo investime në bazene, që detyrimisht edhe ato investime janë pjesë e këtij projekti. Se na me këtë projektin shkojmë deri në fshat, mos më bën tash inxhinier, se nuk jam i asaj natyre, e di që fati i mirë u konë me i gjet mjetet, punët kanë fillue, problemet do t'i zgjidhim hap pas hapi që do të na paraqiten edhe do të mundohna ta çojmë deri në fund këtë projekt. Kjo është lufta, qe ky është investimi ma i madh, ma vital i komunës sonë. E kemi përsërit disa herë, prapë e përsëritim, veç duhet të lutemi që të vazhdojë puna, mos të na dalin probleme tjera. Sa i përket parkut, Nexho, ti e dish shumë mirë se edhe rrugën poshtë na, me bashkëbisedim me qytetarët, me nënkryetarin, me delegatët tjerë, kemi gjet edhe kemi kubëzue edhe ni rrugë të Dragashit poshtë. Mos mendo se nuk do të bisedojmë, do të bisedojmë edhe për atë parkun, ndoshta do të jesh pjesë e grupit të bisedimeve edhe ti. Kurgjo dhunshëm nuk kemi me bo. Mbajtja e projektit, i marrish ti inxhinierat, se unë s'e di tash çka do të ketë, do të ketë pajisje, kushtimisht, sa ma shumë për fëmijë, që të ndihen komod në atë parkun. Për projektin e kanalizimit, njëra prej pyetjeve. Agron, mo për atë pjesën s'kam çka bisedoj, vetëm prej pyetjes çka munda me nxjerrë ishte se të mos dështojnë projektet. Lufta jonë është krejt që asnjë projekt të mos na dështojë, por nganjëherë mund edhe të dështojmë. Na lutemi që të mos dështojë, besoj që administrata nuk ka me e lonë për punë, ka me e bo ritenderimin, po le të kryhet një herë faza e parë, se ka një rregull, duhet të kryhet faza e parë e të gjitha projekteve që të fillojë faza e ritenderimeve. Sepse ni projekt m'u shpallë dy herë, ni projektit mos me i ardhë rendi, edhe ajo është njëfarë lloj diskriminimi. Po megjithatë, sa i përket projektit të Breznes edhe kanalizimit, do të kthehet, për arsye se ka prioritet, do të hyjë menjëherë në fazën e ritenderimit. Driton, sa i përket ndriçimit publik, unë e kam njëfarë përgjigje, po le të të jep drejtori i Administratës përgjigje ma detale. Edhe sa i përket emëtimit të investimeve, ato të cilat i kemi parapa, m'u dok se biseduam. Na me këshillat e fshatrave do t'u vëmë edhe emrat atyre, deri në shtator për secilin investim veç e veç do të bisedojmë me fshatrat. Tash e kemi krijuë, nëse e ke pa në uebfaqe, edhe grupin e ri për dëgjime publike, bashkërisht me ju delegatët, do të ju ftojme edhe nëpër lokalitetet e juaja, edhe qato investime, qato pare që parashihni t'i destinoni nëpër vendet ku ju i shihni të arsyeshme, na do të mundohna t'i realizojmë edhe t'i emërtojmë. Pra edhe këto investime që nuk janë parapa, do të parashihen brenda, deri në shtator besoj se do t'i kryjmë këto.

Uran Halimi: Faleminderit, drejtor! Po e lëmë hapësirën edhe për drejtorin e Administratës.

Vetim Ramadani: Faleminderit, kryesues! Atëherë po ndërlihem me atë që e potencoi ma herët Dritoni. Driton, sa i përket ndriçimit publik, tashmë Komuna ka marrë dy projekte, nëse muj me i qujt si projekte pilot, ku do të provohet marrja përsipër e tërë koston së ndriçimit publik për dy fshatrat ma të mëdhenj të pjesës së Opojës, përkatësisht të Brodosanës edhe të Breznes. Meqenëse këto dy fshatra kanë pasur edhe në Listën e investimeve kapitale investimet në ndriçimin publik, atëherë këtë vit kemi marrë fazë testuese që të shiqojmë marrjen përsipër të koston totale dhe, nëse një gjë e tillë është e përballueshme nga ana e Komunës, i njëjti cikël do të vijojë edhe në të gjithë fshatrat tjerë, kur e dimë se disa fshatra tashmë ndriçimin publik e kanë përfunduar përmes të hyrave të tyre, qoftë të mbledhura nga organizata që janë në diasporë, qoftë nga participimi i qytetarëve apo gjëra të ngjashme, të gjitha ato do t'i vendosim pastaj në kosto të Komunës, Sa i përket mirëmbajtjes, ka qenë më herët një kontratë valide, ajo kontratë tashmë ka skaduar, të njëjtën jemi duke e përgatitur, do të thotë për këtë vit prapë përsëritet e njëjta kontratë, që shërbimet e ndriçimit publik të mirëmbahen, jo vetëm për qytezën e Dragashit, por edhe për tërë fshatrat tjerë ne të cilët Komuna ka investuar, dhe nëse vendosim rrugës që statistikisht dalin matjet që kemi mundësi ta përballojmë Komuna ndriçimin publik, atëherë edhe mirëmbajtja do të përgatitet për tërë komunën. Do të thotë kjo është çështje dy apo tre muajsh, derisa të kemi ni pasqyrë ma të saktë. Unë besoj që për hir të korrektësisë, në seancën e ardhshme, pra në shtator, kur do ta diskutojmë edhe draftin final të KAB-it, aty do ta kemi një pasqyrë më të saktë edhe ne si

komunë edhe bashkërisht me ju do ta diskutojmë modalitetin, cili do të jetë opsioni ma i mirë që ta zhvillojmë këtë kontratë. E ke cek edhe te emërtimi i titujve të projekteve, është fakt që tash për këtë lexim të parë të KAB-it ka mungesë precizimi të lokacioneve, mirëpo duhet theksuar se në sistem edhe po deshëm ne si Komunë, nuk kemi mundësi apo nuk na pranohen nga Thesari nëse i lëmë të hapura, përkatësisht duhet patjetër që të precizojmë lokacionin. Dhe një gjë e tillë në draftin e dytë final besoj se do ta kemi të gatshëm, edhe për ju do të jetë edhe më e lehtë që t'i dini lokacionet saktë, për secilin fshat, ju për fshatin Bresanë apo secili asambleist për fshatrat tjerë. Sa i përket përfshirja e Buzezit në Ujësjellës, edhe deshta me u ndërlihdë edhe me z.Sejdilar, po besoj, në lidhje me Kukajanin atë problemin, apo me Leshtanin nëse nuk gabo, pat problem me pronën private, të njëjtin problem e kemi edhe në fshatin Rrenc, në fshatin ku kalon gypi i Ujësjellësit qendror. Për të gjitha këto është e lejuar një marzhë e modifikimit të cilin ne mund ta bëjmë gjatë rrugës. Pra, nëse kemi rezistencë të qytetarëve, do të shikohet mundësia e devijimit apo të shmangies, në mënyrë që të mos kemi incidente apo qoftë edhe probleme me pronën e dikujt tjetër. Në pronë private na e dimë që nuk kemi të drejtë, përpos nëse ata vetë shfaqin dakordim që të jetë pjesë e saj. Pra, për gjithçka jemi në kontakt të vazhdueshëm me qytetarë. Edhe të mos mbes borxh, sa i përket Kukajanit, ma herët nëse nuk gabo, e potencove që ka edhe një projekt për ujësjellësin edhe Ujësjellësi qendror. Arsyeja pse janë dy projekte është se është një burim tjetër i ujit në fshatin Kukajan, i cili është i paraprë që të inkorporohet në sistemin aktual që e ka. Pra, edhe Ujësjellësi qendror edhe ky ujësjellës që do të ndërtohet, uji do të akumulohet në këtë rezervarin i cili tashmë është veç në shërbim të fshatit Kukajan. Edhe në lidhje me asambleistin z.Gashi, i cili e përmendi çështjen e dështimit të procedurës për tenderimin e kanalizimit në fshatin Brezne. Është njëri ndër projektet, pas Ujësjellësit, me koston ndër më të lartat, përkatësisht ka një vlerë investive prej 300 mijë euro. Ne e kemi zhvilluar procedurën e prokurimit për këtë projekt, dhe pas raportit të hapjes ka rezultuar se vetëm tri kompani i kanë paraqitur ofertat e tyre. Problemi ka qenë se ligjërisht nga ne është kërkuar që ta postojmë në shpallje, që duhet të ketë një referencë secila kompani që do të punojë, meqenëse vlera investive është e lartë, duhet të ketë referencë në punët e kanalizimit në vlerën prej 346 mijë euro. Një vlerë e tillë ka qenë e vështirë që të sigurohet nga kompanitë, dhe të tri kompanitë të cilat kanë aplikuar në tender, të vetmen të metë e kanë pasur te gjetja apo paraqitja e referencave për punë të ngjashme në lëminë e kanalizimit. Pas dështimit është mbledhur komisioni, ka zhvilluar raportin dhe si procedurë është anuluar. Ne i kemi bërë përgatitjet e nevojshme dhe nesër në mëngjes kanalizimi për fshatin Brezne do të del sërish në tender dhe besojmë që këtë herë do të ketë sukses. Ju faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit, drejtor! Jetmir, ni minutë të lutem!

Jetmir Ajdini: Nuk mora përgjigje për pyetjen që ju shtrova. E anashkaluat qëllimisht, ose... ju pyeta për stadionin, cili do të jetë stadioni i qytetit, në Dragash apo në Blaç do të jetë stadioni i qytetit? Shumë pyetje e thjeshtë, besoj njeni prej ekzekutivit keni me dhonë përgjigje.

Uran Halimi: Hajde jepni përgjigje, ju lutem! Kush e di?

Qamil Kolloni: I nderuar delegat! Të dy këta stadione do të jenë nën menaxhimin e Kuvendit Komunal të Dragashit. Ndërsa në stadionin e parë të Blaçit, ju duhet ta dini se na jemi participues, sepse janë tre investitorë, dhe pjesën tonë të punës na jemi t'u e krye edhe nuk ka me pas kurrëfarë problemi, se na do të investojmë edhe shtesë në qoftë se ka nevojë, masi t'i kryjnë dy kompanitë, kompania private edhe FFK-ja investimet në stadiumin e Blaçit. Nuk përfundojnë kreuja këtu, do të investohet edhe ma tutje, po ka qenë qëllimi që sa ma shpejt ta bëjmë funksional, që të mund t'i mbajnë ushtrimet KF 'Ooja'. Këndej ia kemi arrit përmes donacionit tjetër ta ndërtojmë këtë, po kur e kemi fillue në Blaç, nuk e kemi përjashtue këtë stadiumin. Ka qenë çështja e rrugës, të cilën e kemi bashkëbisedue me qytetarët deri kemi gjet modelin ma të mirë të mundshëm për me e hap rrugën për stadion. Kjo domethënë pse ka fillue ne Blaç, nuk e ka përjashtue këtu mosndërtimin e stadionit. Bile këtu kanë qenë delegatët shumë të zëshëm kur kanë thënë se po e anashkaloni ni stadion, po e lini pa bo, po e lini pa krye. Ju kam thonë, ej, mos u ngutni se dy e tre stadione do të bëhen. Do të bëhen stadiumet, po s'bëhen brenda ditës. Ka njëfarë rendi në këtë punë. Kanë fillue edhe anena, kanë fillue edhe knena, besoj se në bazë që qysh do t'i kryjnë punimet operatorët, qaq sa do të mundin të mbrijnë investimet do të mbrijnë, në qoftë se do të ketë nevojë investime shtesë, na prapë edhe mas përfundimit të këtyre projekteve do të shohim mjete tjera shtesë për stadionin, se janë stadione tona. Të dy stadiumet janë stadione të qytetit. Në qoftë se nuk të doket Blaçi ty qytet, atëherë është çështje tjetër, po stadiumet do të jenë të dy stadione të qytetit.

Uran Halimi: Drejtor, nëse mundesh qëndro, veç ni pyetje të ta boj, në lidhje me stadiumin, po e lo atë të Blaçit se ai është i fshatit, s'është i qytetit. Unë kam dëgjue këtu për stadiumin e Dragashit që ka pas keqpërdorime në qeverisje të kalume edhe është investue aty diku rreth 200 mijë euro prej këtij Kuvendi. Qetash, në fushatë i kanë akuzue – i kemi akuzue bashkë, se edhe VV-ja ka reague – e kemi akuzue qeverisjen për atë shpërdorimin e mjeteve të ai stadioni. Qetash po rifinancohet një projekt i tillë. A është i njëjti mbikëqyrës i atij projekti, apo ka ndryshue diçka, a prapë kemi me shkue me keqpërdorime?

Qamil Kolloni: Ni send: unë e di, sa i përket fillimit të projektit të stadionit, punët janë duke shkuar mbarë, përgjegjës është FFK, është investitor numër një, mbikëqyrës është edhe përfaqësuesi jonë. Shpresojmë që investimet tona edhe mjetet të cilat i kemi nda prej qytetarëve të zënë vendin e duhur, të mos keqpërdoren. Do të bëjmë përpjekje deri në fund t'i mbikëqyrim në mënyrën më të mirë të mundshme. Për pyetje me paragjykim, nuk jam profet ta di që a dështojnë apo nuk dështojnë, se nuk është në dorën time. Mbikëqyrësi është i Komunës së Dragashit, me vendim të kryetarit i caktuar, edhe qaj neve na jep llogari. Për atë të parin, e thirrish qeverinë tjetër që ka qenë, pararendëse, ata të japin përgjigje, se nuk e kam kqyrë arkivin edhe për momentin s'e di kush ka qenë. Edhe sa i përket keqpërdorimeve, janë organet tjera të cilat janë marrë, është bo edhe auditimi i asaj. Janë auditorët, janë organet e hetuesisë edhe të prokurorisë. Na jemi për me krye punë, nuk jemi për me shkue nëpër gjykata edhe m'i ndjek njerëzit.

Uran Halimi: Domethënë, kur ju e hulumtoni edhe e gjeni ni keqpërdorim, heshtni apo? S'jeni për m'i çue njerëzit në gjykatë, po e lini kështu në harresë, hajt se na s'jemi konë vallahe, nasht çka kongra bo. Sidoqoftë, po vazhdojmë. E hedhim në votim, e kemi pikën e dytë të rendit të ditës, është fjala për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2024-2026. Unë edhe në fillim ju thashë që s'e kisha përkrahë këtë Kornizë Afatmesme Buxhetore, me plotë të meta edhe lëshime. Sidoqoftë, ju ftoj në votim! Kush është pro pikës së dytë të rendit të ditës? Kush është kundër kësaj pike të rendit të ditës? Abstenim? Konstatoj që me 13 vota pro, me 10 vota kundër edhe me zero abstenim, kalon pika e dytë e rendit të ditës. E kemi qetash pikën e fundit në rend, është pika eventuale. Po e nisim me debat. Fjalën e kërkoj z.Nexhat Selaj.

Nexhat Selaj: Përshëndetje edhe ni herë! Jo se ma dhaje fjalën, kryetar, po ndoshta edhe më takon, se në seancën paraprake e ndërpret në momentin kur u duhke kryetari me m'i dhonë disa nga ato sqarimet të cilat kam kërkuar, disa përgjigje. Po prapë pyetjet të cilat duhet të m'i japë kryetari, kryetarin nuk e kemi këtu. Do të presim në seancën tjetër. Pyetjen për arsim që e kam dedikue – kryesues, nëse bon pak me dëgjue – thashë pyetjet të cilat i kam të dedikuara, por kryetarin nuk e kemi këtu dhe nuk muj di kush mund të më jap përgjigje. Pyetjet të cilat i kisha për Drejtorinë e Arsimit, drejtorin nuk po e shoh këtu, s'di sa mund të më jap kush përgjigje. Në mungesë të tyre, unë e kisha vetëm një kërkesë. Besoj që në seancat tjera prapë do t'i kërkoj nga kryetari dhe nga drejtori i Arsimit ato pyetjet të cilat i kam kërkuar. Unë e kisha një kërkesë, po nuk di cilit dikaster t'i paraqes kërkesën edhe lutjen, por po besoj që mund të zë rrugë tek Urgjenca. Në fshatin Zym, te vendi i quajtur 'Te Trafa', sigurisht se ju ka bo vaki të gjithëve, është në interes shoqëror, mo nuk po flas, se po përmenden lokalizma, nuk do të flas në aspektin e bashkëfshatarëve ose të rrethanave të fshatit nga vij unë, pasi që është rrugë e cila lidhë komplet mikroregjionin. Në atë vend janë bllokuar disa, nja 20 metra gypa nëntokësorë dhe pjesa tjetër e ujrave të zeza derdhen mbi rrugë. Kështu që edhe me 30 km/h, mos të thona 40 km/h, në ditë të verës rrëshqasin makinat dhe si pasojë e kësaj, këto ditët e fundit, pak si është nxeh moti, kemi pesë apo gjashtë ndeshje të komunikacionit. Rrëshqet makina sikur të është akull. Me sinqeritetin ma të lartë po ju them se në këtë kohë të Kurban Bajramit vetë isha në fshat dhe përderisa kam qëndruar vetë në kafiteri, kam pa me sytë e mi dy ndeshje, të cilat për fat të Zotit ato kaluan pa lëndime dhe lus që mos të ketë edhe lëndime tjera. Për atë arsye, derisa nuk është bo keq, mos të kemi ndonjë fatalitet, për pak punë edhe për pak angazhim mos ta lëmë që të rrezikohen aty banorët edhe të gjithë qytetarët të cilët kalojnë gjatë asaj rruge. Edhe ni herë, në emër timin personal, pasi që vetë kam qenë prezent dhe kam vërejt rastet e policisë, janë tri raste të policisë, brenda dhjetë dite janë tri ndeshje komunikacioni, por unë vetë kam vërejt dy, njëra ishte e lajmëruet në polici, njëra ishte marrëveshje mes dy atyre makinave të cilat shkaktuan aksident. Derisa nuk është bo ndonjë aksident, i cili mund të merr edhe jetën e njerëzve, po ju kërkoj që nga ekzekutivi, në kohën ma të shpejtë të mundur, nëse është e mundur me intervenue. Faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit, z.Selaj! Unë deshta me propozue diçka në lidhje me formimin e një komisioni në lidhje me ato pagat që shumica e delegatëve më keni akuzue mu. Është mirë që na sot me e formue ni komision,

secila parti politike duhet të ketë përfaqësuesin e vet. Domethënë komisioni ka me u përbë nga një anëtar i secilës parti politike edhe ka me hetue brenda ni muaj dite, ka me hetue cilat janë lëshimet në lidhje me pagesat. Kemi bo kërkesa vazhdimisht te zyrtari i Financave, mirëpo nuk kemi mund me e gjet ni përgjigje të saktë edhe ku është e meta e atyre, mungesat që vazhdimisht kemi pas në lidhje me pagat edhe mëditjet e seancave të Kuvendit. Andaj, ftoj shefat e grupeve parlamentare që të na sjellin nga një emër, ose po e hedhim në votim propozimin. Okej, po e hedhim në votim propozimin, nëse jeni dakord edhe ju, po e formojmë një komision që me e hulumtue. Nëse kalon propozimi, atëherë i qesim emrat. Kush është pro propozimit që na me e themelue ni komision për me e hetue çështjen e mospagesave? Na jemi Kuvend edhe kemi të drejtë me themelue komisione sa herë që na dojmë. Më gjej ku neve na ndalon? A duosh me e marrë fjalën, a duesh me hesht? Unë e qes propozimin, nëse ty s'të pëlqen si propozim, mundish mos me e votue edhe me e injorue, kurgjo ma shumë. Atëherë të nderum delegatë, kush është pro propozimit që na si Kuvend me e themelue ni komision për me hetue çështjen e pagave? Nuk po due me e themelue kokë në veti, po e themeloj për shkak që unë kam marrë vazhdimisht krtika edhe akuza nga ju, delegatë, për mospagesë të mëditjeve. Kush është pro këtij propozimi për me e themelue këtë komision? Kush është kundër këtij propozimit? Abstenim? Ju faleminderit! I kemi 13 vota pro, 1 kundër edhe 4 abstenime. Tash ju lus që secili përfaqësues i subjekteve politike të na sjellë emrin e kandidatit të tyre për anëtar të komisionit. E ftojmë grupin më të madh parlamentar, në këtë rast është PDK-ja, që të na sjellë emrin e vet në lidhje me këtë komision. Ky komision obligohet që në shtator, domethënë në seancën e shtatorit të raportojë gjendjen edhe problematikat. Patjetër që mundesh me dalë.

Samidin Xheladini: Të nderuar të pranishëm! Komisioni është një organ i cili raporton gjendjen faktike. Na nuk jemi as prokuror, as gjykatës, as polic, as kurgjo. Zyra gjegjëse, zyra numër 9, ka bo gabime. Tash, a ka bo zyra numër 9, a ka bo qendra në Prishtinë, a kush ka bo, gjendja faktike është qashtu. Fyese është për delegatët që na me u marrë me këto çështje. Me të vërtetë është fyese, po qe pesë muaj po bëhen. Ju lutem, është nevojë imediate që ky komision të formohet, pa u konsultue me askënd, kjo është bindja jeme personale. Komisioni me u formue edhe duhet me e gjet gjendjen faktike edhe me i drejtue kush është fajtori, se më duket edhe mandateve të kalume, po ju argumentoj që deputeti i Asamblesë Komunale nuk ka marrë katër vite rrogë. Ndërsa ni deputet, s'po due me përmend emra, katër vjet i ka marrë ka dy rroga. E dinë këta deputetët ma të vjetër edhe organet e dinë. Jo, deshta me thonë që faji i njerëzve adekuatë, që ka punue aty dikush, e i ka bo këto, me qëllim i ka bo. Edhe masnej na jemi detyrue Komuna me ia pague atij asambleistit pagat prej buxhetit. Domethënë është nevojë, le ta shohim na, ishalla s'kanë faj këta kërkush, edhe e shohim na ku është gjendja, problemi. Faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit, z.Xheladini! Komisioni ka për detyrë që në seancën e shtatorit të raportojë gjetjet. Nuk po paragjykoj, as s'po hamendësoj për ndonjë lëshim të mundshëm, të qëllimshëm, mirëpo ato lëshime të cilat janë bo, ka me i hetue komisioni, edhe besoj që me sugjerim të komisionit kanë me u rregullue ato lëshime që jan bo, po besoj të paqëllimshme. Arsyeja pse unë e propozova këtë është që vazhdimisht jam akuzue edhe jam kritikue në lidhje me mospagesat e asambleistëve. Është diçka që unë absolutisht nuk kam pas fare të bëj me pagesa. Gjithçka që unë e boj është me e dërgue atë listën e pjesëmarrësve të Asamblesë, me e thirrë seancën, ndërsa me pagesat nuk merrem fare. Më është përmend emri, ka thënë kryesuesi ashtu, ka thënë kryesuesi kështu, mirëpo te pagesat kryesuesi s'ka çka thotë. Pagesa është çështje e dikujt tjetër, s'duhet m'u konë çështje e jemja, edhe me diçka që unë nuk ngarkohem, me diçka që unë s'jam i ngarum me bo nuk merrem realisht. Kështu që, ftoj PDK-në që me na pru ni emër në lidhje me ni anëtar të mundshëm, i cili do të jetë pjesë e komisionit për hetimin e kësaj çështjeje. Shpetim Hajredini, a mundish me na sjellë ni emër?

Shpetim Hajredini: Atëherë, në emër të grupit të PDK-së po e propozoj profin Nexhat Selaj.

Uran Halimi: Faleminderit! Nga PDK do të jetë z.Nexhat Selaj. Ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar të LDK-së që të na propozoj një emër.

Naser Myrtezani: Faleminderit! Unë që reagova, për vete, edhe mandatin e kaluet edhe këtë mandat kurrë asnjë problem s'e kam pas. Dhe për këtë reagova. Na e propozojmë Samidin Xheladinin. Faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit shumë! Ftoj përfaqësuesin e VAKAT që ta bëjë një propozim.

Miralem Rahte: Përshëndetje të gjithëve! Propozoj Munir Jonuzin. Faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit shumë! Munir Jonuzi nga VAKAT. E ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar të LVV që të na japë emrin e tij.

Jetmir Ajdini: Ne nga LVV propozojmë z.Uran Halimi që të jetë pjesë e komisionit. Faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit, Jetmir! Nga JGP, ftoj përfaqësuesin e tyre që të na japë një emër, kush do të jetë anëtar i komisionit.

Ventaza Esati: Përshëndetje të gjithëve! Nga JGP propozojmë Edin Kurtin.

Uran Halimi: Faleminderit shumë! Nga JGP, përfaqësuesi i tyre do të jetë z.Edin Kurt. Të nderuar delegatë, i kemi pesë emra, me e përfshi edhe z.Sejdilar, atëherë po bëhet numri çift. Atëherë duhet m'i bo shtatë. Agron Gashi edhe Nedžmidin Sejdilar. Atëherë po i lexoj edhe një herë emrat: nga PDK është z.Nexhat Selaj, nga LDK është z.Samidin Xheladini, Munir Jonuzi është nga VAKAT, Uran Halimi nga LVV, Edin Kurt nga JGP, Agron Gashi AAK, edhe nga PG është Nedžmidin Sejdilar. Domethënë i kemi shtatë anëtarë të këtij komisioni. Unë po besoj në këtë komision që ka me i zbardhë pak a shumë të metat edhe lëshimet të cilat kanë ndodhë. Po ju falënderoj për mbështetjen e këtij propozimit! Thjesht, mu më është hek ni barrë edhe ni përgjegjësi të cilën s'e kam pas, po thjesht jam akuzue edhe po më thonë që na duhet këtë komision, emrat e këtij komisioni me i qit në votim. Kush është pro këtyre emrave në këtë komision? Realisht është një komision që e propozum secila parti politike, është mirë me e mbështet, po sidoqoftë ju e dini. Kush është pro? Kush është kundër këtyre emrave? Abstenim? Atëherë i kemi 18 vota pro, zero kundër edhe 4 abstenime. Kalon komisioni, faleminderit shumë për këtë bashkëpunim! Po e vazhdojmë seancën, e kemi pikën eventuale. Para se me e mbyllë, është mirë unë me ju thonë edhe ni informacion. DEMOS ka kërkuar që na me e pas ni takim, është mirë na me e bo këtë takim, mirëpo për datën edhe kohën e ka kërkuar që na me e vendos. Unë po propozoj që, nëse mendoni ju që të martën mundim me e mbajt atë takim, takimi ka me ndodhë te La Ruota në Tyrbe të Pllavës. Të martën po e lomë. Okej, e lëmë për të martën, faleminderit shumë, unë po e informoj atë zonjën. Jo, ka ndërrue data, nuk është i 30-ti, thjesht ka pyet ajo kur neve na konvenon. Nëse na konvenon për të martën, po e lomë për të martën. Koha 09:30-10:00 besoj që është, si çdo trajnim ma herët që e kemi mbajt. Po vazhdojmë me pikën eventuale. Kush do me e marrë fjalën? Fjalën e ka znj.Arijeta Skeraj, pas saj fjalën e ka z.Artan Loshaj dhe pas Artanit fjalën e ka Nedžmidin Sejdilar.

Arijeta Qafleshi Skeraj: Përshëndetje kryesues, përshëndetje për të gjithë! Edhe pse u stërzgjat shumë kjo, edhe unë nuk pata dëshirë me dalë me folë, po pasi kryesuesi shumë e ekzagjeroi punën e dëgjimit publik, e mora ni vendim që ta dal e të flas. Sa herë jemi thirrë nëpër dëgjime publike, unë kam pas punë, ndoshta unë jam konë në punë edhe s'kam mund me ardhë. Edhe tash që kam ardhë pi ndihna shumë e degradume pse kam ardhë, kur nga asambleistët edhe nga kryesuesi thuhet që kemi ardhë me skenar. Unë personalisht, flas veç për vete, kurrë nuk jam konë me skenar. Unë veç vetë vij. Në tri mandatet kurrë një herë, asnjë kryetar nuk ka guxue mu me ma shkruar diçka edhe me dalë me folë këtu. Unë jam unë edhe nuk due. Ma herët kryesuesi e kritikoi drejtorin e Ekonomisë edhe i tha mos guxo me m'i prek asambleistët. Ky ke sot që na kritikoi neve. Na në dëgjimin publik nuk jemi konë me skenar, unë po flas për asambleistët e LDK-së. As nga kryetari që është në pushtet, po as nga kryetari i partisë, as edhe një bisedë të vetme s'kemi pas. Na si grup i grave kemi pas dy organizime, në fshatin Bresanë edhe në fshatin Kosavë, dhe i kemi pa ato çka na kanë ofrue për me i kërkuar në dëgjimin publik. Mu po më vjen keq që jemi, ni herë ma s'pari se una jam konë gjithmonë e bullizume edhe për këtë pjesë mu aspak s'më intereson. Po më vjen keq që edhe shoqet e mia në këtë gjë po bullizohen. Neve si asambleiste, ndaç në dëgjim publik, ndaç në seanca na jemi, unë personalisht jam veç vetë, çka mendoj dal e foli. Edhe, as kryetari që është në pushtet mu nuk ka të drejtë me m'thonë del e fol atë, del e fol këtë. Për qat arsye edhe e mora këtë vendim me dalë me folë. Mu po më vjen keq! E dyta, te pagesat, unë jam konë e bullizume prapë te pagesat. Unë s'kam të boj as me menaxherin e pagesave, as me askënd. Unë edhe vetë – kryesues dëgjo – edhe vetë kryesues me ty kam qenë, me Artanin edhe me dy tjerë që s'po i përmendi, jem konë te menaxheri i Financave para tri-katër dite edhe kam thonë në qoftë se mu më qitet pagë ma e madhe, atëherë ti kie m'u ballafaque me mu. Unë e due veç pjesën teme. Nuk due me u bullizue, edhepse e kam marak pak me bullizue njerëzit. Faleminderit shumë!

Uran Halimi: Valla më bone m'u ndie keq, Arijetë! Unë realisht s'po e ndij veten që të kam ofendue absolut. Unë e akuzova qeverisjen edhe thashë që debatet publike, në bazë të trajnimit që na e kemi mbajt, organizohen nga asambleistët, së bashku, në mbështetje me ekzekutivin. Kur një herë neve na kanë thirrë, si delegatë, me bo ni debat publik, ti e dish shumë mirë. Qetash me e lujt viktimën, qato m'u dhimte, po kur e di që s'je viktimë, s'po di qetash a po më dhimesh a s'po më dhimesh. Kështu që s'ka të bëjë me bullizimin kjo. A është me

skenar, ajo është me skenar, se na nuk e kemi thirrë debatin publik, apo? As s'e kemi udhëheq. Delegatët duhet me e udhëheq, e dish shumë mirë që e kemi bo trajnimin. Nëse jem gabim, unë ju ftoj edhe juve delegatë, të cilët keni qenë prezent në atë trajnimin që e kemi mbajtur në Prizren, nëse jam gabim dilni edhe më thoni që je gabim. Mirëpo, debati publik, sipas atij trajnimit, ku ka qenë USAID, sipas USAID-it, debatet publike thirren nga Kuvendi, organizohen nga delegatët, në mbështetje të ekzekutivit. Kjo ke ajo që unë e thashë. Nëse ti je ndie e bullizume, ajo është perceptim i yti, unë absolutisht s'kam pas të bëj me bullizimin. Te puna e pagave u fute vetë, se unë s'përmenda kurgjo. Dikush më ka thënë që s'ma kanë qit pagën. Na e dimë krejt që do paga s'janë qit. Jeni dëshmitarë, e kemi thirrë edhe këtu atë zyrtarin. Qetash a të ka qit ty shumë, unë këtë s'e thashë. Domethënë, ku dhemb dhëmbi, shkon gjuha. Ty garant t'kam dhimt dhomi qaty, e të shkoj gjuha me kallxue qetash çka ka ndodhë. Sidoqoftë, unë s'po hi në atë çështje, po po kallxoj anën ligjore, që debatin publik duhet me e organizue Kuvendi. Pse e ka organizue kryetari, e di ai vetë. Mirëpo, debati publik, edhe kur na kanë pyet neve, zonja Fatime ka pyet a keni organizue debat publik, i kam thënë jo. Ademi tha u organizue, thashë Kuvendi s'ka organizue. A u konë qeshtu? Kuvendi thashë s'ka organizue. Duhet me organizue Kuvendi. Thashë Kuvendi s'ka organizue. Qeverisja po, Kuvendi jo. Domethënë, edhe ky debati publik i kalum u desht me u organizue nga Kuvendi, nga KPF-ja sidomos. Domethënë, dikush tjetër i bën punët tona. Për qato s'kam qef me ia bo unë dikuj punën e vet. Punët tona janë tonat, të Kuvendit. Na kemi të drejtë me e bo komisionin edhe e bëmë, është punë e Kuvendit. Na s'presim me na bo komision dikush tjetër. Është përgjegjësi edhe e drejtë ligjore. Kështu që, znj.Skeraj, mos u ndiej e bullizume, se s'kam pas qëllim me të fye edhe me të bullizue. As ty, e askënd tjetër. E marrish fjalën e marrish fjalën, s'është problem, unë të ngoj, jam i gatshëm me të ngue apet. Nëse duesh, fjalën ta jap. Fjalën mas znj.Skeraj e pat Artan Loshaj dhe pas tij z.Sejdilar.

Artan Loshaj: Përshëndetje për të gjithë! S'po di sa po ia vlen me diskutue, për arsye se shumë herë kam diskutue, drejtori i Shëndetësisë edhe kryetari nuk kanë dëgjue, sepse nuk e di ku u konë problemi. Unë e di që tupanat bien për ata që kanë vesh, këta është dashtë deri më sot me bo naj lëvizje, naj diçka. Qaq mirë drejtori, nëse do me më dëgjue, as dëgjuet s'i vë me m'dëgjue. S'po di a e ka mësue gjuhën shqipe, bare ta përgëzoj. Due me m'dëgjue. Okej. Edhe ni herë pra, e përgëzoj drejtorin për gjuhën shqipe që e ka mësue pa përkthim. Para nja dy-tri dite në Komitet kemi diskutuar, kam marrë do përgjigje as për së afërmi që janë. Due me i tregue drejtorit se koeficienti për punëtorët e QKMF-së ka dështue. Punëtorët e QKMF-së janë të vetmit në Republikën e Kosovës që nuk kanë përfutue nga rritja e koeficientit në krejt Republikën e Kosovës. Drejtori e di shumë mirë, po me siguri edhe kryetari s'e ka lonë me dalë me diskutue apo nuk do me diskutue, se nuk din. Kujdestaritë janë ulë nga 18 në 7 euro për kujdestari. Këtë e di edhe zonja e nderume Ventaza, që punon vetë me këtë ndërrimin. Tjetër, e vetmja QKMF që pas orës 22:00 deri në ora 07:30 në mëngjes punon me një infermier. Kur s'e di drejtori a e di mirë se çdo pacient që shkon me autoambulancë për Prizren, duhet me shkue me përcjellës. Në qoftës se mas orës 10:00 shkon me përcjellës autoambulanca, aty krejt QKMF, krej Komuna e Dragashit jetë vetëm më një mami. Kjo është turp! Na ka premtue në Komitet që në muajin korrik dhe në gusht do ta shton stafin. Zotni drejtor, a mas shtatorit nuk do të ketë të sëmure a? Domethënë, pacientët tonë kanë të drejtë me u smu veç në muajin korrik edhe në muajin gusht. Mas muajit shtator, prapë do të vjen me avazin e vjetër. Kryetari, e kemi pyet këtu, nuk na ka dhonë përgjigje, është e vetmja QKMF, me sektorin e Urgjencës që shkon në aksidente me dhunë edhe shkon pa mjek. Hiç ma larg se ditën e shtunë i kemi pas tre aksidente për 15 minuta. Ambulanca ka qenë në Prizren, ndërsa për fat të keq, e dini shumë mirë që ka pas ni aksident me fatalitet afër Restorant 'Dasmë', është dashtë mjeku kujdestar të lajmërohet nga policia dhe nga infermieri prej Prizrenit, ta thirrin ni mjek tjetër, për me e zavëndësue, për me shkue me e pa rastin edhe për me e konstatue vdekjen, se e dini shumë mirë kush është mjek këtu, që konstatimin e vdekjes infermieri nuk mundën me bo se është shkelje ligjore. Është mirë drejtor, që së paku ta keni një staf rezervë për raste shumë ekstreme. Për shembull, ni mjek, ni infermier dhe ni vozitës të jenë në gjendje gatishmërie 24h, që bare për kësi raste shumë të rënda, për aksidente të rënda, ta keni dhe të shkoni nëpër vende të aksidentit. Për mungesë barnash, e dish shumë mirë që ka mungesë barnash, u arsyetove edhe ditën e parë, po arsyetohesh edhe sot që është e drejtë e ministrisë. Ti ke qenë edhe në mandatin e kaluar drejtor, edhe në mandatin e PDK-së, nuk je fillestar, e dish shumë mirë që ni tender kur e kam përmend këtu, mbi 57 mijë euro, pra aty keni ble barna nga Lista esenciale, keni ble barna me afat të skaduar, por ka qenë e kalume. Unë kam thirrë, edhe prapë thirri me u hetue ky rasti. Nuk po lypim na barna nga Lista esenciale, por po lypim barna për raste super ekstreme, bare

mas orës 10:00, kur mbyllen barnatoret. Hiç ma larg, javën e parë kemi pas aksident edhe nuk ke pas infuzion për me ia kyç, për me e çue pacientin në Prizren. Jemi detyrue me marrë borxh edhe për me transportue pacientin në Prizren. Zotni drejtor, qe ni javë, e dish shumë mirë që nuk ju punon laborator. Prej hapjes së QKMF-së deri në këtë ditë të sotit, pacientëve të Komunës së Dragashit iu merret gjaku në QKMF edhe i çoni me autoambulancë në Krushevë për m'i bo analizat. Kjo është e pafalshme. Doktorin e kemi këtu, mjek. Nuk kam të drejtë me diskutue shumë, se laborant s'jam. Si është e mundur të merren mostrat e gjakut në QKMF dhe t'i transportoni në Krushevë, të bëhen analizat? Çfarë analiza do të dalin aty? Do të mbahesh mend si një drejtor që bojsh transportin e mostrave të gjakut Dragash-Krushevë dhe anasjelltas. Pse, z.drejtor, nuk hi në funksion laboratorin e QKMF-së në qendër? Pastaj do të shkojmë edhe te participimi. Kush ka qenë delegat i mandatit të kaluar – qe Arijeta edhe drejtor Naseri kanë qenë, po s'po rrinë këtu me ngue – e dini shumë mirë që me vendim të këtij Kuvendi, me vota unanime, ti e dish shumë mirë drejtor, këta tjerit s'po e di delegatët e vjetër, me vota unanime është larguar participimi për hir të Pandemisë. Dhe vendimi i këtij Kuvendi Komunal ka qenë deri në përfundim të Pandemisë të lirohen nga participimi të gjithë qytetarët e Komunës së Dragashit. Ju e dini shumë mirë që Pandemia, afër dy muaj ka përfundue. Ju qe dy muaj ditë deri në këtë moment e shkëlqi edhe ligjin e shëndetësisë, e shkëlqi edhe ligjin e këtij Kuvendi Komunal. Unë e di që keni problem me e riaktivizue participimin, se do të ju bëhet kundërfushatë në zgjedhje, por po të lutem unë, qite si ekzekutiv, qitne në rend dite për participimin që në qoftë se doni me i lirue prapë pacientët nga ky moment, unë do të votoj për, veç mos boni shkelje. Në qoftë se mendoni qeshtu, unë edhe ni herë po të thom, duhet të del në votim, jemi apo nuk jemi për vazhdimin e participimit që të largohet, se përndryshe jeni t'u bo shkelje ligjore. Edhe te transparenca, ma herët z.Kolloni, drejtori tha jemi shumë transparentë. Masi jeni shumë transparentë, nja dytri herë i kam bo pyetje kryetarit, nuk na ka dhonë përgjigje, sot në mungesë të kryetarit po kam qef me ia bo ni pyetje drejtorit. Zotni drejtor, mjekët specialistë, pensionerat që po punojnë në QKMF, sa e kanë pagën, se është ni e drejtë ligjore me e ditë, edhe sa e kanë kontratën, a kanë kontratë, deri kur kanë kontratë edhe kur iu skadon kontrata. Faleminderit!

Nedžmidin Sejdlar: Përsëritje për të gjithë, pasi kryetari nuk është këtu dhe nuk ka kujt t'i drejtohet drejtpërdrejt me pyetje. Ata do të paraqesin vetëm atë që është më e rëndësishmja, dhe për pjesën tjetër do të presim që presidenti ynë të kthehet nga udhëtimi. Nuk e di se kush e zëvendëson saktësisht kryetarin e komunës, por dua të pyes pushtetin ekzekutiv dhe shoh që këtu nga pushteti ekzekutiv nuk po dëgjon askush, as drejtori i administratës, as drejtori i financave. por ne do të flasim për rekord. Rruga mes Viva Fresh dhe fshatit Plavë gjatë natës është katastrofike për vozitje dhe të gjithë jemi të vetëdijshëm në këtë sallë që kemi pasur një rast me përfundim fatal. Për shkak të supermarketit të hapur, shumë qytetarë shkojnë në atë treg, rruga është e pandritur dhe nuk ka trotuare. Ngasësit e kanë shumë të vështirë të shohin nëse ka ndonjë pengesë në rrugë dhe dua të përmend edhe një herë se kemi pasur një aksident me fatalitet në atë pjesë të rrugës. Unë dua t'ju pyes nëse keni ndonjë qëllim apo plan për ta zgjidhur atë problem. Aty humbëm një jetë njerëzore. Aty kemi një pikë karburanti, kafene, një qendër tregtare, një lagje që është ndërtuar ndërkohë dhe ka shumë këmbësorë në rrugë. Dhe unë jam i mbushur me dritë. Kam frikë se nuk do të ndodhë më ndonjë rast fatal. A keni ndonjë qëllim për ta zgjidhur atë problem, për të mbrojtur jetën dhe qytetarët. Unë kam folur këtu më parë për një tub që plasi pas komisarariatit dhe ujërat nëntokësore po shkatërrojnë pronën private të njerëzve që jetojnë atje, çfarë bëtë për këtë. Ne po kërkojmë një përgjigje. Më 26 të këtij muaji kishim një komision për komunitete ku të pranishëm kishim mysafirë nga Malisheva. Në atë komision u përpoqa të merrja disa përgjigje nga zoti Kolloni që i kisha parashtruar në seancë pak kohë më parë dhe për të cilat mora pjesërisht përgjigje. Mirëpo, jo përmes organizimit të komisionit, ka ndodhur një incident ku, pranoj, kam reaguar në mënyrë të papërshtatshme dhe në njëfarë mënyre e kam kërcënuar kolegun tim Miralem Rahte se do t'i jap një shuplakë dhe do t'i thyej kockat. Për aq kohë sa më shërben kujtesa. Me këtë rast, zoti Rahte, ju kërkoj ndjesë. Me falni nuk po ju kerkoj te me jepni amnisti, meqe e keni dorezuar ceshtjen ne polici, nuk po ju kerkoj te me jepni amnisti, jam pro qe ligji te jete i barabarte per te gjithë. nese jam fajtor le te denoj para ligjit por ne ate rast duhet te denohen edhe ketu te tjeret. Ndër të tjera, miku im i dashur Samidin Xheladini për seancën e kaluar, ja ky zotëria që ma hoqi me dhunë mikrofonin, për atë kërcënimin në autobus ku ishim të gjithë bashkë nëse ju kujtohet dhe kishte pak incidente nga të gjitha anët. Ndaj nuk po ik nga ligji, kam bërë vepër penale apo kundërvajtje çfarëdo, ju kam kërcënuar, ishte thjesht një kontakt verbal zotëri, nuk keni nevojë të më keni frikë në rrugë. Unë po ju jap fjalën

time këtu, përpara gjithë Kuvendit dhe publikut dhe nëse ju kërcënova në një takim privat të mbyllur për publikun. Këtu po ju kërkoj falje publike. Unë nuk kërkoj nga ju të më jepni amnisti, për fajin tim do të paguaj dënimin e parashikuar në ligj, por të gjithë këtu duhet të trajtohen në të njëjtën mënyrë. Si dhe rastet që sapo përmenda. Sepse të gjithë jemi nën ligj njëllor dhe. Edhe një herë ju kërkoj falje që ju dërgova kërcënime. Ato ishin vetëm verbale, mos kini frikë nga unë.

Uran Halimi: Faleminderit, z.Sejdilar! Është mirë me e rujt gjuhën, sidomos mes neve. S'është gjest i mirë edhe qytetarët me na dëgjue t'u fye edhe rëndue me fjalë njëri-tjetrit. Unë të përgëzoj për guximin që e ke marrë me i kërkue falje personit në fjalë. Është një veprim goxha i mirë edhe besoj që na nuk duhet me pas hatërmbetje. Mbase edhe mund të gabojmë, ta fyejmë dikë, mirëpo është mirë që na me e pranue gabimin edhe, si në rastin në fjalë, me i kërkue falje personit të cilit mendojmë që e kemi fye. Ajo çka është ma e mira është mos me ardhë puna deri në qat masë, mirëpo edhe nëse vjen edhe e vërejmë gabimin, atëherë është mirë me kërkue falje. Realisht, nëse s'ka mo pyetje...nuk ka ndodhë kjo në seancën e kalume, unë qysh e di ka ndodhë në Komitet. Po e ndërpreva, se unë u detyrova, për mos me ardhë puna deri....arsyeja pse unë e ndërpreva seancën, ju e dini shumë mirë, për me e rujt integritetin e secilit prej juve, unë e ndërpreva seancën që mos me ardhë puna deri te ni fyerje ma e rëndë verbale ose qyshdoqoftë, bon vaki edhe ni konflikt fizik ka mund me ndodhë. Kjo është arsyeja pse unë e ndërpreva seancën. Mirëpo, në momentin kur shkon seanca qysh duhet edhe në mënyrën ma të mirë të mundshme, unë s'kam arsye për me e ndërpre. Unë jam detyrue për me e ndërpre, për me e ndërpre një eskalim të situatës. Kështu që, kërkoj mirëkuptimin edhe nga ana juaj për mbylljen e seancës në atë mënyrë, jam konë i detyruem për me bo. Nëse doni diçka me shtue në lidhje me këtë çështje, është mirë me i harrue këto çështje. Okej, fjalën e ka kërkue z.Samidin Xheladini.

Samidin Xheladini: Shiqoni! Kryesues, ti duhet me e udhëheq mbledhjen qysh duhet, edhe shkaktar i ekseseve, i incidenteve, je pjesë edhe ti. Sepse atë ditë përgjegjësinë ma të madhe e ke pas ti. S'kam dashtë me e thonë këtë, por po e thom me plotë përgjegjësi. Pagesat në Kuvend - le ta nije opinionit qetash, po due krejt me e ditë - 150 euro është rroga e asambleistit. 150 euro është për ata që janë në marrëdhënie pune. Le ta dijë krejt opinionit i gjerë që na marrim që jemi në marrëdhënie pune ka 150 euro. Është turp me e thonë unë, se s'më takon mu me e thonë, por po duhet me e thonë, se po e ndij përgjegjësi me e thonë, se kërkush s'po e përmend. Edhe unë kam dëgjue fjalë nga kolegët e mi, na kanë ndalë rrogat, na kanë ardhë rrogat zero-zero. Edhe personalisht e kam ndije veten përgjegjës, edhe unë kam tentue me e zhblllokue problemin. Qe katër-pesë muaj kjo. Kam has në probleme dhe ndoshta edhe kërcënime. Mu ma kanë pru emailin, bashkë si juve që jemi me dy punë, me e nënshkure cila është paga primare. M'u deklarue me ligj. Dhe mu personi zyrtar m'ka kërcënue mu se s'guxojsh ti me nënshkrue. Tjerët e kanë nënshkrue, a me të mirë a me të keq s'e di. Mu më ka detyrue me dhunë me e nënshkrue qysh do ai, unë e kam nënshkrue qysh kam dashtë unë edhe mandej më ka thirrë mu kryetari, domethënë vëllai jem, m'ka thirrë tri herë së unë bëhem shkaktar i mospagesave të rrogave, edhe unë e kam lënë të lirë kryetarin me vendos çka të dojë, për hir që mos t'i marrë në qaf, që unë m'u bo shkaktar me i marrë në qaf edhe asambleistët tjerë. Me dy paga publike, po. Ata të cilët marrin ni pagë nuk kanë pas probleme, po edhe kanë pas probleme ata të cilët - për atë kam kërkue komision, edhe unë e kam njoftue kryetarin që njerëz të caktuar po flasin, filani fisteku, emrin tënd po e përmendin. E ka thirrë zyrtarin këtu, kryetari ka bo gabim fatal që s'e ka lënë zyrtarin me dhonë përgjigje, se sot nuk ishte formue qeky komision. Edhe tash, kolega që më përmendi mu, ka nxjerrë ni fakt të rrejshëm edhe unë jam dëshmitar i faktit të rrejshëm. Edhe unë nuk kam mund me e përbi se ai po del para opinionit edhe po shet mend, se etiketohet së pari subjekti jem. Kryetari s'e di, unë e di, që ti ke dëshmue me dokument ni dëshmi të rrejshme, edhe unë kam reague, mos rrej t'kam thonë, se është e vërtetë që ke rrejt, edhe dy herë ke rrejt atë ditë, mu më ka ardhë rëndë. Opinioni e din që qashtu është e vërtetë. Të lutem, unë kam reague prej vendit, të kam thonë mos rrej, s'është e vërtetë, këto mandatet e kalume kanë ndodhë. Ti argumento që kanë ndodhë këtë mandat. Unë e pranoj, po, është e vërtetë, se unë e di sigurt. Domethënë ke shpif. Të lutem, s'lejoj me shpif, qaso shpifje të rënda. Unë s'lejoj edhe të reagoj prej vendit. Ky zotnia ka qenë dashtë me e vazhdue seancën deri në fund, edhe unë u çojshom e diskutojshom, e jo me ma mohue mu te drejtën, unë me dalë këtu për shembull, e jo prej vendit. Shtatë-tetë herë ta ka dhonë fjalën, ke dalë ke fye, na ke fye të gjithëve, s'kemi bo zë, fyerje të rënda na ke bo. Ndoshta dikujt tjetër nuk i vjen aq rëndë, mu më ka ardhë shumë rëndë edhe unë s'kam reague prapë. Ty as një kërcënim s'ta kam bo hiç personalisht, as kërkuj qetu hiç. Të lutem, s'u konë e vërtetë se të kam kërcënue, kam thonë...

edhe unë kam pas propozim me bo, ty me të përjashtue prej seancave, po prapë jam sugjerue mos me e bo. Me të përjashtue prej seancave gjashtë muaj ditë, për hir se je i padisciplinuet. Të lutem!

Uran Halimi: Faleminderit! Ni minutë replikë, Sejdlar.

Nedžmidin Sejdlar: I nderuar Zotëri apo Zonjë, unë jam njeri prej mishi dhe gjaku, dhe kur bëj një gabim, kërkoj falje pa masë dhe kjo nuk është problem. Nuk duhet të them se çfarë ndodhi seancën e kaluar, të gjithë e pamë se çfarë ndodhi, ndoshta po paraqes një argument këtu që është i pasaktë, por po e paraqes këtu nga kjo podium. Unë thashë se jam prej mishit e gjakut dhe se mund të bëj gabime. Ndoshta kam informacion të gabuar ose ndoshta po them diçka gabim, por për ne delegatët vendi i diskutimit është këtu, kjo podium. Dhe jo për të hedhur nga vendi siç bënim më parë. Një gjë tjetër, problemi në klinikën në fshatin Restelicë, një koleg pyeti dhe në atë takim unë fillova të largohem dhe të gjithë jeni dëshmitarë. Ne kishim një takim në Prizren, ju kolegu këtu më sugjeruat që të qëndroj këtu dhe të krijoj kuorum për ju, sepse po të largohesha nga ajo seancë nuk do të kishte kuorum atë ditë. Prita një orë të plotë për një përgjigje, erdha në foltore për të shpjeguar atë që ishte e paqartë dhe është mirë që pyete përsëri. Ambulanta në Restelicë, e kam parë nga mediat ku kryetari ynë ka bërë fotografi aty në hapjen e asaj ambulanta, drejtori aktual ka bërë fotografi në hapjen e asaj ambulante. Dhe nuk mund të kthehem 60 vjet prapa dhe të gjurmtoj se kush ka bërë çfarë. E kam parë nga mediat që drejtorët tanë dhe kryetari ynë po mburren. Sulmova drejtorin këtu dhe kryetarin aktual se nuk ishin kushtet atje. Unë nuk shoh se çfarë është e diskutueshme për këtë. Çfarë lloj të pavërtetës është pyetja. E kam parë nga mediat. Nga mediat të afërta autoriteteve. Ato media që duhet të publikojnë gjithçka që thotë qeveria. Unë jam një njeri që kur gabon, kërkon falje. Edhe unë i psoj dënimet që janë paraparë për këtë, por përpiqem të mos shaj askënd nga ky vend, sepse dikush ndihet i provokuar nga dalja ime pas foltores. Por kushdo mund të provokohet, edhe nëse e pyes si jeni.

Uran Halimi: Qetash, nëse vazhdojmë me folë prej vendit, mu më detyroni prapë me e bo atë. Nëse folim prej vendit, unë veç ju përshëndes, e dini ju shumë mirë. Kështu që, lënja fjalën kur ta merre, le ta kryje debatin, mundeni me marrë fjalën secili prej juve në foltore.

Uran Halimi: Faleminderit! Ni fjali e ka, ni minutë z.Xheladini.

Samidin Xheladini: Kolega e dëgjoji rastin e parë. S'jam unë kompetent me i dhonë kësi përgjigje, po pasi që po heshtet, e vërteta duhet me dalë në shesh. Rasti ka qenë për ambulantën e Restelicës, na vetë e kemi votue vitin e kaluar renovimin. Drejtor, a ka sivjet renovim Ambulanta e Restelicës? Projekt e kemi na të paraparë, qysh? Bresana, Restelica, renovimi i ambulantave. A ka, a s'ka? Po a jo? A mirë, u krye. Se na të kemi kërkuar, e kemi na në projekt që ka renovim, a sivjet a në mot, ti e kie në plan. A e kie në Plan? Planin e Punës e kemi na. Pse s'po dalish me e dhonë shpjegimin? Unë po duhet me dalë.

Uran Halimi: Në fund drejtorat kanë me dhonë sqarim. Faleminderit, z.Xheladini! Fjalën e ka kërkuar z.Shpetim Hajredini.

Shpetim Hajredini: Atëherë, përshëndetje edhe ni herë për të gjithë ju kolegë, të cilët jeni tash prezent. Kuorum besoj që kemi, i nderuar kryetar. Se në çdo seancë po e diskutojmë, po e shikojmë ni herë, kur po vijmë pikat e fundit të diskutimit, po e shikojmë a kemi kuorum a jo, ndërsa rrogat po i lypim në fund a i kemi mirë apo jo. Formojmë komision këtu për me i shiku rrogat, as nuk marrim përgjegjësi asnjë prej nesh. Duhet të kemi frikën e Zotit, o burrë, qe sa seanca, të gjitha seancat, i këna dy vite, as kolegët e mi, a prej partive të tjera, të gjithë ikin kur vjen puna në eventuale apo ma herët. Japin nënshkrimin në fillim të seancës edhe nuk i intereson askujt mo çka ndodh. Jo, në këtë moment kenë ma shumë të LDK-së prezent. Okej, tash po dalin nja dy, po mbesim baras tash, po shumica prej PDK-së nuk i kie këtu, e kanë lëshue seancën. Kjo për mu është absurde. Nuk e di qysh mujsh të dalish para qytetarëve ti një ditë dhe lypish votë pastaj, kur në asnjë seancë nuk ke prezantue deri në fund. Po më vjen shumë keq, më erdhi edhe rëndë që vendosa ta thom këtë, po kjo është për mu e drejtë edhe të drejtës nuk i iki unë deri në fund. Tjetra, për të cilën e mora fjalën, ka të bëjë me kanalizimin e fshatit Kuk. Nifare përgjigje e mora prej drejtorit, tërthorazi e tha, po jam i detyruar prej pronarëve të tokave që patjetër ta paraqes këtë problem. Është mbi tre muaj ai kanalizim, ai shakt i bllokuar dhe ai ujë i ka dëmtuar ato prona. Unë e kam përjetue katër vite këtë problem, e di si shkojnë gjërat. Jam mundue shumë herë me...mos ta thom tash, po pasi hina po e thom, masi e di Zoti, unë me financa të mia shumë herë i kam zhblllokue vetëm për mos me i dëmtue ato prona. Se në formën dhe mënyrën si i kam gjet unë ato prona, domethënë para katër viteve, ato ni pjesë shumë e madhe ka qenë e papunueshme, pastaj i kam kthye të

punueshme dhe kanë qenë shumë në rregull, tani prapë ishin kthye në batak. Ish intervenue, e pashë aty që ish intervenue diçka, mirëpo prapë nuk ish funksional. Është mirë që shumë shpejt të merrni masa, të diskutoni me ndonjë kompani. Po më vjen shumë mirë që e paskna atje përgjegjës, me të cilin edhe kam kaluar shumë mirë për katër vite, Sebahat Hasanin, ai e din mënyrat dhe format unë qysh kam arrit ta realizoj edhe t'i zhblllokoj këto. Kështu që, është mirë me diskutue me to, le ta gjeje një gjuhë të përbashkët me ndonjë kompani të Opojës, edhe jam i bindur që e kryen ndoshta edhe pa shpenzime. Por mos e lini ashtu, se ato toka janë të papunueshme për momentin. Është mirë që këtë ta kryni brenda në javë, bile shumë është edhe kjo në javë. Ju kisha lut që këtë ta kryni sa ma shpejt që të jetë e mundur. Tjetra ka të bëjë me qat projektin trevjeçar, të cilin prej fillimit, unë vetë e kam premtue dhe në fund mezi e kam shti edhe tash po realizohet. Falënderoj Zotin që po realizohet! Asfaltimi i rrugës së Bjeshkës, por me punët nuk jam i kënaqur personalisht. Kam qenë, edhe pse shkoj fshehurazi i shikoj, se nuk kam qef me më pa, për arsye se gjatë katër viteve, kundërshtarët politikë të cilët i kam pas, nuk më kanë pengue asnjëherë në punime. Edhe unë nuk kam qef tash m'i pengue. Ajo që po më shqetëson është se trashësia e cila është parapa të hedhet në atë rrugë, si nga fraksionet e trasha, si nga ajo që i bjer tamponi apo faza e fundit, nuk janë duke shkue në bazë të paramasës edhe janë shumë të ulëta. Po mirë, z.Sebahat, masi je këtu sot prezent, të dalish pak më shpesh, t'i shikosh punimet edhe pa t'i sulmosh. Jepju pak sulm, përndryshe...unë po besoj që ka me u realizue projekti, edhe po shpresoj që së paku fundi të jetë i mirë. Të jetë i mirë për qytetarët dhe fshatarët, në veçanti të fshatit Kuk. Ju faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit, z.Hajredini! Fjalën e ka z.Nexhat Selaj edhe në minutë, ka me shtue diçka.

Nexhat Selaj: Përhëndetje edhe ni herë! Me keqardhje, por po duhet me e thonë, përderisa kërkojmë, jam me kolegën, me Samidinin, që të shiqohen të gjitha këto vonesa edhe mospagesa. Por isha për një propozim, kryesues, nëse veç pajtohen kolegët, që për delegatët, nëse thirret seanca në ora 10:00, ne të lajmërohemi në ora 10:00, kurse nënshkrimet të bëhen në kohën kur mbaron seanca. Nuk po mundem me e marrë me mend sa mund të është njerzore, nuk po flas më ligjore, kur ne të cilët paguhemi nga 150 euro jemi të gjithë prezent këtu, kurse kolegët deputetë të cilët mariin nga 545 euro mos gabofsha, po më duket se një ose nuk është asnjë këtu, mos gabofsha. Po, një thashë...kështu që jam i mendimit që të lajmërohemi në kohën e ardhjes, kurse nënshkrimet t'i japim në kohën e mbarimit të seancës. Faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit, z.Selaj! Kjo është diçka shumë e mirë. E kam mendue vazhdimisht me të thënë të drejtën, mirëpo me e inicue unë si rast nuk ma ka marrë mendja, për shkak që unë e kam mandatin e parë këtu në këtë Kuvend edhe me bo ndryshime. Është mirë me bo ndryshime pozitive edhe në të mirë, mirëpo s'e kam ditë a e kam përkrahjen e juve, po apo jo. Na në ni seancë të radhës mundim me e marrë ni vendim të tillë që pa u krye seanca mos me i qit nënshkrimet. Në momentin që na e mbyllim seancën, e qesim edhe Listën për me nënshkrue, edhe secili prej neve e jep nënshkrimin edhe largohet nga seanca. Nëse e marrim si vendim me vota unanime, me shumicë të votave, është ide e mirë. Nëse jo, e lëmë në ndërgjegjen e secilit. Kështu që, nëse do dikush me e marrë fjalën për pikën eventuale, munden. Për replika unë s'po besoj që kemi nevojë. Nëse s'ka dikush që do me e marrë fjalën, atëherë i ftoj përfaqësuesit e ekzekutivit që të përgjigjen në pyetjet që ju sapo i bëtë. Fjalën e ka z.Vetim Ramadani, drejtor i Administratës komunale.

Vetim Ramadani: Faleminderit, kryesues! Atëherë po filloj nga e para, meqenëse drejtori i Emergjencave edhe Shërbimeve Publike nuk gjendet këtu. Në lidhje me shqetësimin që e ngriti z.Selaj, ne tashmë, sot kemi proceduar me kanalizimin për në fshatin Kuk, dhe këtij kanalizimi ne do të bëjmë të pamundurën që nesër në mëngjes ta ndërpresim si procedurë, t'i kalojmë inxhinierat në terren, ta shiqojmë gjendjen, si qendron gjendja faktike në fshatin Zym dhe të marrim masa sa më parë. Meqenëse, nëse nuk gaboj, në bazë të asaj që e paraqitet ju, është diku 20 metër problem, nuk ka ma shumë, atëherë besoj që shumë lehtë mundemi me e sanue edhe me e rikhye në gjendjen e mëparëshme, edhe me i shmang ato aksidentet e mundshme, qoftë edhe kundërmimin e erës në atë pjesë. Do të thotë, qysh nesër, besoj që do të marrim masa edhe do ta inkorporojmë në pjesën e paramasës së tenderit për kanalizimin. Këtu shfrytëzoj rastin që të inkorporohem edhe në pyetjen që e bëri z.Hajredini, sa i përket kanalizimit në fshatin Kuk. Kanalizimi në fshatin Kuk, është bërë incizimi i terrenit dhe është përgatitur paramasa, ka një vlerë të përafërt prej 5900 euro, afër 6 mijë euro, dhe nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve e Drejtorisë së Emergjencave sot është përgatitur drafti final i paramasës. Parashihet, saktësisht nuk mund t'i tregoj krejt paramasat, po parashihet ni ndryshim, ndërrim i gypit për tri kaptazha, dhe njëkohësisht edhe pahitë mbrojtëse për atë pjesë.

Uran Halimi: Ju faleminderit, drejtor! Dikush tjetër a do me e marrë fjalën? E ka kërkuar edhe ni minutë drejtori i Shëndetësisë më doket, apo?

Behar Brenoli: Zoti Kryesues, pak më parë u detyrova t'i përgjigjem pyetjes suaj. A ishte pyetja gabim apo e kam keqkuptuar vetë, por kjo nuk ka më rëndësi, sa i përket mjeteve për mallra dhe shërbime, supozova se e dinit se për çfarë janë përdorur ato fonde dhe nuk ka pasur nevojë t'i përgjigjeni kësaj pyetjeje. Tani po them që të gjitha kostot që ndodhin në shëndetësi, nga ngrohja te kostot e higjienës, mirëmbajtja e makinave, higjiena, janë të gjitha kosto mallrash dhe shërbimesh. Sa i përket koeficientëve të teknikëve, ne si komunë i dërguam ministrisë listën e punëtorëve me koeficientët që menduam se i meritonin sipas ligjit të ri të pagave dhe aty renditëm koeficientët më të lartë që menduam se i meritonin. Ka pasur probleme, mangësi, disa kanë koeficientë më të ulët e disa kanë më të lartë, por kjo është përgjegjësi e ministrisë, nuk është e jona, disa nga punëtorët tanë janë ankuar, disa ankesa janë pranuar, të tjera janë ende në shqyrtim. Si komunë do të punojmë që secili prej punëtorëve tanë të marrë pagën apo koeficientin që meriton. Unë ju premtoj atë. Në përputhje me aftësitë tona dhe përgjegjësitë që kemi. Sa i përket kujdestarisë, gatishmëria është e rregulluar me ligj dhe kam kërkuar rreptësisht që punëtorët tanë të respektojnë ligjin dhe që kushdo që punon qoftë edhe një minutë më shumë, në kujdestari, të paguhet çdo punëtor. Kemi folur shumë herë për teknikët dhe punën e tyre pas orës 10:00. Kur bëmë një premtim me kryetarin e komunës se do të përpiqeshim të siguronim një teknik tjetër në gatishmëri gjatë verës. Ne nuk thamë që njerëzit sëmuren vetëm gjatë verës, por e thamë vetëm sepse numri i pacientëve gjatë verës është më i madh dhe e pamë të përshtatshme që nëse është e mundur të punësojmë edhe një teknik. Që nuk do të thotë që njerëzit nuk sëmuren jashtë kësaj periudhe. Dragashi nuk është e vetmja komunë në Kosovë që ka një qendër kryesore të mjekësisë familjare. I gjithë territori i Kosovës ka të njëjtin sistem shëndetësor dhe e njëjta gjë bëhet. Një ekip është në detyrë. Ka praktika të ndryshme nga qendrat dhe komunat, disa komunat mbyllin AMF dhe shkon i gjithë ekipi dhe ndonjëherë shkojnë vetëm teknikët dhe kjo varet rast pas rasti. Mendoj se qendra kryesore e mjekësisë familjare ishte shumë e mirë. Ai ofronte shërbime maksimale të mira sipas mundësive të tij. Për sa i përket ekipit rezervë, besoj se çdo punonjës shëndetësor është gjithmonë punonjës shëndetësor si kur është në punë ashtu edhe kur nuk është, kur ndodh ndonjë rast, detyra e tij është të vijë në ndihmë dhe të ndihmojë. Ne nuk mund të kërkojmë që të vijnë në Dragashë nga Restelica apo Zapluxhe apo nga Brodi nëse është emergjente, sepse do t'i duhet shumë kohë që të arrijë në Dragashë. Sa i përket barnave, thamë se lista e barnave esenciale është në përgjegjësi të ministrisë dhe nëse ministria na e jep të gjithë furnizimin e Kosovës, nuk do të na mjaftojë. Ne kemi bërë shumë hapa në këtë drejtim, deri më tani kemi pasur sukses. Gjërat po përmirësohen. Kemi disa ankesa nga disa punëtorë që e kanë mësuar më herët, se nuk ka njeri në kontroll, si shpenzohet gjithçka, e di që do të kemi ankesa, por kjo do të zgjidhet së shpejti. Nuk mund të bëhet brenda një dite. Sa i përket furnizimit, unë kam qenë edhe drejtor në mandatin e kaluar, vitet e kaluara kemi pasur programe të veçanta financimi nga Banka Botërore dhe në ato programe kemi blerë barna. Nuk ishin nga buxheti i shëndetësisë, i cili atëherë ishte 130 apo 150 mijë euro. Këto ishin grante speciale. Sa i përket laboratorit, laboratorit në Dragash është duke punuar. Vetëm një pajisje nuk funksionon. Ai u prish tre ditë më parë. Me shumë mundësi do të rregullohet nesër ose gjatë fundjavës. Nëse dikush mendonte se po përfitonte prej saj, e kishte gabim, sepse gjetëm një zgjidhje. Nuk e di sa është e saktë, por nga qendra kryesore e mjekësisë familjare u binda se nuk ka fare problem nëse mostrat merren dhe analizohen në Brodosavcë apo Krushevë. Nuk ka asnjë ndryshim në rezultate të tilla. Për sa i përket participacionit, ky kuvend ka marrë një vendim, nëse e ndryshoni, ne do ta respektojmë. Dhe për sa u përket specialistëve, kontrata me organizatën që kemi është njëvjeçare, kur të përfundojë ajo kontratë do të marrim një raport të plotë financiar. Sa janë paguar dhe ne do t'jua dorëzojmë atë.

Uran Halimi: Faleminderit shumë, drejtor!

Artan Loshaj: Po ia nisim prej participimit, prej fundit. Ky Kuvend ka vendos, po vendimi i ka shkue edhe kryetarin të Komunës. Domethënë kryetari i Komunës dhe drejtori i Shëndetësisë është për ta zbatuar këtë vendim. Unë thashë edhe ma herët, jam për vazhdimin, por duhet të qitet në rend dite dhe të votohet, përndryshe jeni ilegalisht t'ò punue. Dy, për analizat, thashë edhe ma herët, 55 vjet, 60 vjt punon QKMF, kurrë s'ka ndodhë kjo. Gjëja më e vogël e mundshme çka mujsh me bo ti është me dhonë dorëheqje. Tre, te koeficienti, përgjegjësinë nuk e keni ju. Po kush e ka përgjegjësinë? Ju e udhëhiqni politikën shëndetësore. Kur po duhet me largue participimin, me e largue koeficientin, po, prej 18 euro në 7 euro, bon, kqyre ligjin. Kur duhet të

drejtat e punëtorëve me i respektue, veç dy-tre vetëve jau keni rrit prej 20 punëtorëve, aty s'keni të drejtë me i mbrojt. Domethënë, me jau hek keni të drejtë, prej 18 në 7 euro, keni të drejtë me i bo, po kur duhet me i mbrojt, me jau rrit koeficientin, se ka aty me Bachelor, ka aty me Master, aty ju nuk keni të drejtë, duhet ligji. Te punëtori, ti, unë s'e di, krejt sendet mundish me i ditë, veç shëndetësinë s'mundish me e ditë, problem politik i yti edhe të kanë pru si kukull. Kërkund në botë, doktorin e kemi këtu, Ventazën e kemi këtu, Arijetën e kemi këtu, kërkund në botë nuk ka ni infermier me punue me ni mjek. Çdokund, në Prizren, në Suharekë, në Malishevë, e kie ni mjek me dy e gjys, me tre infermierë. Tjetra është, të thashë edhe ma herët, se ti këtë e bojsh për inate, se unë e di çfarë je ti, se ti tjetër send s'dish, veç inat dish me bo. Problemi është që ni infermier kur të shkon me rast për Prizren, vetëm mamia jetë në QKMF, në krejt Komunën e Dragashit. Turp është për ty kjo fjalë, me thonë edhe në vendet tjera janë qeshtu, mbyllen ambulatat. Në Prizren mbyllet ambulanta, po është qendra kryesore, është spitali i madh. Ata shkojnë në terren, po është spitali i madh. Tjetra, kur thaje s'un vjen prej Brodit, prej diku tjetër për me ardhë me dhonë ndihmë. Ditën e shtunë e kemi pas aksidentin me fatalitet, është turp për ty. Moralisht s'ke dalë bare me kërkue falje. Një orë ka prit në vendngjarje për me shkue me e konstatue vdekjen. Ni infermier nuk ka të drejtë të shkon me e prek, jo me e konstatue vdekjen. Po ti këtë s'e kuptojsh, nuk mundni me e kuptue ju këtë. Nuk ka të drejtë infermieri me konstatue vdekjen. Ni orë ka prit xhenazja te "Dasma", mos ta traumatizojmë atë familje kur të njihë çka po diskutohet këtu. Ni ora ka prit për me shkue me e konstatue vdekjen. Është turp për ty, ti duhet moralisht me dhënë dorëheqje edhe m'u lirue kjo ngulfatje e Shëndetësisë.

Uran Halimi: Faleminderit! Doktor Jetmiri po do diçka me na folë në lidhje me këto çështje që i ngriti drejtori bashkë me Artanin.

Jetmir Ajdini: Përshëndetje edhe ni herë! Nëse puna në Qendrën e Mjekësisë Familjare në Dragash, në Urgjencë, organizohet nga ni mjek edhe ni infermier, është shumë pak. Është punë që s'munden me e bo ni mjek edhe ni infermier, ni kujdestari 24-orëshe. Mungesën e stafit është përgjegjësi e drejtorit të QKMF-së, gjithashtu përgjegjësi edhe e drejtorit të Shëndetësisë qysh organizohet puna në QKMF. Nëse ke mungesë të stafit, duhesh me bo kërkesë për shtim të stafit. Nëse veç kie staf, e organizojsh punën edhe e pagun kujdestarinë për secilin infermier ose mjek që vjen me majt kujdestari. Nëse ti e ke lonë Qendrën e Mjekësisë Familjare me ni mjek edhe ni infermier, atëherë nuk e di për çka je drejtor i Shëndetësisë. Nëse e kemi na ni rast në terren edhe qaj ekip duhet me dalë në terren, kush është në Qendër të Mjekësisë Familjare për me ofrue ni shërbim urgjent? Nëse ka me na ndodhë ni rast urgjent, që shumë shpesh ndodh. Se është komunë që i ka 30 mijë banorë, 30 e kusur mijë banorë, edhe ni motër me e mbajt Qendrën e Mjekësisë Familjare, kjo është për turp, kjo është për me dhonë përgjegjësi. Ju si drejtor i Shëndetësisë ma s'pari, ma s'dyti drejtori i QKMF-së, të gjithë në nivel përgjegjës. Kjo është nevojë urgjente, me e bo riorganizimin e punës në Qendrën e Mjekësisë Familjare, gjithashtu edhe në Urgjencë, me e gjet mënyrën qysh me organizue, me pas staf të mjaftueshëm për nevoja urgjente të qytetarëve. Nëse veç nuk ke me gjet, të ofrojmë me dhënë dorëheqje edhe me ia dhënë dikuj tjetër mundësinë, që di me e bo këtë punë. Faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit, z.Ajdini! Unë po besoj që qytetarët s'e meritojnë m'u konë në këtë gjendje, pa shërbime mjekësore. Vetëm për inate politike, ose qysh tha Artani, nëse ka të bëjë me inatin këtu, nuk është në rregull. Inatet duhet me i lonë, punën duhet me e krye. Kemi përgjegjësi me të cilat jemi ngarkue edhe duhet me i çue deri në fund. Faleminderit shumë për pjesëmarrjen, e kryjmë këtë seancë edhe shihemi në seancat e radhës!

Kryesuesi i Kuvendit: Uran Halimi
